

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7859 E hënë 22 Prill 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion **i** Ditës

Takimi i Berlinit, në të cilin, më 29 prill, do të mblihen liderët e Ballkanit Perëndimor dhe ku nikoqir do të jenë kancelarja gjermane, Angela Merkel dhe presidenti francez...

Vijon në faqen 20

Nga BEKIM BISLIMI

Heqja e vizave, kërkesa e vetme unike e Kosovës në Berlin



Opinion **i** Ditës

Nga FATOS ÇOÇOLI

A lçide de Gasperi, ish-kryeministër italian (1945-1953) dhe një nga themeluesit e Europës së Bashkuar që kemi sot, deklaronte se "Një politikan mendon për..."

Vijon në faqen 21

Gjithshka për të rinjtë?



Numri dy i PD: Demokratët më të bashkuar se kurrë

Bindja Demokratike? Bardhi: Nuk na shqetësojnë shtojcat e partive ekzistuese

Nga partia e re e Rudina Hajdarit te shanset për të qenë Edi Rama sërish kryeministër...

Partia Demokratike është e vendosur që të mos bëjë asnjë hap pas nga beteja e saj për të garantuar në Shqipëri zgjedhje të lira dhe të ndershme dhe një qeverisje legjitime. Numri dy i kësaj force, sekretari i Përgjithshëm, Gazmend Bardhi në një intervistë për "Gazetën Shqiptare" shprehet se nuk do të pranohet asnjë lloj zgjidhje...

Në faqen 3

AKSIONI/ POLICIA NUK JEP EMRAT, DY TE PRANGOSURIT 28 DHE 29 VJEÇ

SUPERVJEDHJA NE RINAS, ARRESTOHEN 2 TE DYSHUAR

Dy të ndaluarit mendohet se kanë modifikuar furgonin e Rinasit, me mbishkrimin "Hetimi Tatimor". Detajet e operacionit të bluve në Elbasan



(Në foto) Momenti i grabitjes së parave në Rinas. Furgoni me të cilin u krye grabitja.



Në faqen 7

ZBARDHEN DISKUTIMET

Strategjia e PS, paketa e ligjeve në drejtësi miratohet para negociatave

Në faqen 5

MESAZHI I METES

Përgjaken Pashkët, 207 të vvarë e 450 të plagosur në Sri Lanka

Në faqen 9

HISTORIA

Si u ruajtën kambanat e kishës së Shmisë nga familja Thekna

Në faqen 6

SHOWBIZ

Jorida Tabaku në pritje të ëmbël, pas dy fëmijëve vjen gëzimi i 3-të

Në faqen 18

1.8 MILIONE VOTUES



Presidenti i ri, INA: Blerim Reka ka fituar mbi 80 mijë vota

Në faqen 12

Psikologjia: Këshilla të vlefshme për prindërit e vogëlushëve të prekur

Lorela Garuli: Shenjat që tregojnë çrregullime te fëmijët

Ylli Merja: Kuroni ulcerën e ngërçet e stomakut me lulen e basanit

Nga VOLTIZA DURO

Pra moshës 7 vjeçare, fëmijët mund të shfaqin një lloj çrregullimi të vëmendjes, i njohur ndryshe si ADHD. Në një intervistë për suplementin 'Life Pages' në 'Gazeta Shqiptare', psikologjia Lorela Garuli tregon se fëmija mund



të paraqesë nivele më të larta impulsiviteti, mungesë vëmendjeje dhe hiperaktiviteti sesa fëmijët normalë. Ajo shton se djemtë preken më shumë nga ky çrregullim e më tej tregojnë të gjitha simptomat për 3 kategoritë e grupit të sjelljeve...

Suplement

OPOZITA PËRÇARJA

Shenjat se palët mund të ulen në tryezën e bisedimeve, ende mungojnë

Deutsche Welle: Situata politike favorizon idenë e Rudina Hajdarit

"Partia do t'i lejojë opozitës së re të regjistrohet në KQZ"

Opozita e re zyrtarizoi të enjten në parlament formimin e 2 grupeve të reja parlamentare për të mundësuar kështu funksionimin pothuajse normal të parlamentit shqiptar me 102 deputetë. Sipas Kushtetutës duhen 140 deputetë pjesëmarrës në Kuvend. Njëri grup quhet "Grupi Parlamentar Demokratik" dhe drejtohet nga deputetja e Partisë Demokratike, (PD) Rudina Hajdari, e cila refuzoi vendimin e PD, në shkurtin e kaluar, për të hequr dorë nga mandati i saj parlamentar. Në këtë grup bën pjesë edhe deputeti i PD, Myslim Murrizi, që si Hajdari refuzoi të njëjtin vendim si edhe 6 deputetë që morën mandatin nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve prej listës së kandidatëve për deputetë të PD, në zgjedhjet parlamentare 2017. Grupi tjetër parlamentar opozitar, i quajtur "Grupi i Pavarur" është formuar nga deputetët e rinj të Lëvizjes Socialiste për Integrim, po nga listat e kandidatëve për deputetë dhe përbëhet nga 8 deputetë. Kryetarja e Grupit Parlamentar Demokratik, deputetja e PD, Rudina Hajdari dha të premtën detajë për orientimin e grupit dhe synimet e tij. "Grupi Parlamentar Demokratik është formuar në përpunje të plotë me Rregullat e Procedurës së Parlamentit, ligjet në fuqi dhe Kushtetutën e Shqipërisë. Ky grup formohet sipas një orientimi të djathtë politik që synon zgjidhjen e krizës politike përmes reformimit të sistemit elektoral politik; përfaqësimin e vërtetë dhe integritetin e demokratëve, të opozitës së qytetarëve në parlament; integrimin e Shqipërisë në BE" theksoi kryetarja e grupit, Rudina Hajdari. Por po kaq e rëndësishme sa synimet e grupit duket edhe ideja e një alternative të re politike të djathtë. Rudina Hajdari e artikuloi mjaft qartë kur theksoi se "grupi i saj parlamentar po ecën drejt shndërrimit në një forcë të re politike".

SITUATA POLITIKE

Situata politike në Shqipëri



Deputetja e Partisë Demokratike, Rudina Hajdari

Nesër afati i fundit, regjistrohen 34 parti për zgjedhjet vendore

Ka skaduar dje në mbrëmje afati ligjor për regjistrimin e partive politike si subjekte zgjedhore për vendore e qershorit. Gjithsesi KQZ për shkak se afati i fundit i regjistrimit i ra e diel dhe për më shumë ditë feste, është detyruar që ta shtyjë këtë afat deri të martën. Pra, të gjitha partitë që duan të marrin pjesë në zgjedhjet për pushtetin vendor deri nesër kanë afatin e fundit. Deri më tani në KQZ janë regjistruar plotësisht 25 forca politike, mes të cilave edhe Partia Socialiste, Partia Socialdemokratike e Skënder Gjinushit dhe pjesa tjetër janë parti jo parlamentare që kanë një mbështetje shumë të vogël në elektorat. Ndërkohë që KQZ ka lajmëruar mbajtjen e një mbledhje ditën e nesërme për të regjistruar plotësisht 9 parti të tjera, ndërmjet të



cilave një pjesë e tyre janë ose forca të djathta ose në opozitë me PS-në. Siç bën të ditur Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e së martës pritet të regjistrohen 9 parti të reja: Partia e Reformave Demokratike Shqiptare, Partia Demokratia Sociale e Paskal Milos, Partia Zgjidhja e Koço Kokëdhimës, Partia e Pajimit Kombëtar, Partia Social-Punëtores, Partia Ligj dhe Drejtësi e Spartak Ngjelës, Partia Fryma e Re

qipëri e favorizon idenë e Rudina Hajdarit. Janë dy opozita, që burojnë po nga PD, që kanë qëndrime të kundërta ndaj angazhimit në procesin politik, pjesëmarrjes në zgjedhjet lokale: opozita e re në parlament deklaroi pjesëmarrjen, tjetra, në rrugë e sheshe deklaroi mospjesëmarrjen, për sa kohë nuk do të jetë larguar kryeministri Rama dhe nuk do të jetë ngritur një qeveri kalimtare që të "organizojë zgjedhjet të lira dhe ndershme". Krijimi i një force të re politike të djathtë do t'i lejojë opozitës së re parlamentare të regjistro-

het në KQZ si subjekt politik, të paraqesë kandidatët e vet brenda afateve kohore të parashikuara në Kodin Elektoral dhe të përgatitet për fushatën elektorale. Por shpresat që, opozita e re e përfaqësuar me grupin parlamentar demokratik dhe ajo e protestave, të marrin

SITUATA POLITIKE

Situata politike në Shqipëri e favorizon idenë e Rudina Hajdarit. Janë dy opozita, që burojnë po nga PD, që kanë qëndrime të kundërta ndaj angazhimit në procesin politik, pjesëmarrjes në zgjedhjet lokale: opozita e re në parlament deklaroi pjesëmarrjen, tjetra, në rrugë e sheshe deklaroi mospjesëmarrjen, për sa kohë nuk do të jetë larguar kryeministri Rama dhe nuk do të jetë ngritur një qeveri kalimtare që të "organizojë zgjedhjet të lira dhe të ndershme".



PARTITË E REGJISTRUARA, MES TYRE FRD E TOPIT DHE ZGJIDHJA E KOKËDHIMËS

1. Partia Socialiste e Shqipërisë - Edi Rama
2. Partia Socialdemokratike Shqiptare - Skënder Gjinushi
3. Partia e Gjelbër - Edlir Petanaj
4. Partia Kristian Demokratike - Dhimitër Muslija
5. Partia Aleanca Demokratikane - Zef Bushati
6. Partia Socialiste e Moderuar - Gjerqij Koja
7. Partia Unitetit Kombëtar - Idajet Beqiri
8. Partia Emigracionit Shqiptar - Kostaq Papa
9. Partia e Personave me Afësi të Kufizuar - Gjovalin Shqalshi
10. Partia Lëvizja Punëtores Shqiptare - Genci Sakaj
11. Partia e të Drejtave të Mohuara - Ilir Vata
12. Partia Demokratia e Re Europiane - Koçi Tahiri
13. Aleanca për Barazi e Drejtësi Europiane - Valentino Mustaka
14. Partia Demokratike për Integrim dhe Prosperitet - Kujtim Muça
15. Partia Ardhmëria Shqiptare - Emin Subashi
16. Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen - Kristo Kiço
17. Partia për Demokraci dhe Solidaritet - Gaqo Apostolo
18. Partia për Mbrojtjen e të drejtave të emigrantëve - Ymer Kurti
19. Partia Komuniste e Shqipërisë - Qemal Cicolari
20. Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar - Ylber Valteri
21. Partia Ora e Shqipërisë - Zef Shtjefni
22. Partia Bashkimi Liberal Demokrat - Arjan Starova
23. Partia për Liri, Demokraci dhe Etikë - Arjan Galdini
24. Partia Kombëtare Konservatore - Kujtim Gjuzi
25. Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtores - Kadri Isufaj

PARTITË QË KANË BËRË KËRKESË NË KQZ

26. Fryma e Re Demokratike - Bamir Topi
27. Lista e Barabartë
28. Partia Zgjidhja - Koço Kokëdhima
29. Partia Demokratia Sociale - Paskal Milo
30. Partia Ligj dhe Drejtësi - Spartak Ngjela
31. Partia Socialpunëtores Shqiptare - Ramadan Ndreka
32. Partia e Reformave Demokratike - Krenar Rryçi
33. Pajtimi Kombëtar Shqiptar - Spartak Dobi
34. Aleanca Kuq e Zi - Kreshnik Spahiu

pjesë në zgjedhjet lokale si një opozitë e tërë nuk janë shuar. Për më tepër zyrtarizimi i 2 grupeve parlamentare opozitare është shoqëruar me përsëritjen e apelit nga faktori ndërkombëtar, drejtuar PD dhe LSI, që të marrin pjesë në zgjedhjet lokale si një opozitë e plotë. "Opozita ka nevojë për të biseduar me njëra-tjetrën dhe me qeverinë për të gjetur një zgjidhje për një pjesëmarrje të plotë në zgjedhje. Është koha për dialog", apelo këtu fundjavë ambasadori i BE në Tiranë, Soreca.

ZGJEDHJET LOKALE

Por shenjat se palët mund të ulen në tryezën e bisedimeve ende mungojnë. Kryeministri Rama ka deklaruar në mënyrë të përsëritur se "mandati që i kanë

dhënë votuesit PS, të qeverisë vendin deri në 2021, nuk mund të negociohet. PS nuk jep pushtet në tavolinë. Opozita të vijë në pushtet me anë të votës, konkurrimit në zgjedhjet parlamentare të radhës, në 2021." Në aksionin e deritanishëm politik të opozitës janë vetëm protestat dhe jo dialogu. Protestat e saj antiqeveritare rifillojnë në muajin e ardhshëm, më 11 Maj. Por përveç mospjesëmarrjes PD deklaroi së fundmi, se do të pambledhë përmes përkallëzimit të aksionit opozitar dhe qytetar, mbajtjen e zgjedhjeve fasadë, të diktuara nga krimi i organizuar dhe paratë e pista që shkatërojnë demokracinë dhe vullnetin e qytetarëve shqiptarë".



Partia Demokratike është e vendosur që të mos bëjë asnjë hap pas nga beteja e saj për të garantuar në Shqipëri zgjedhje të lira dhe të ndershme dhe një qeverisje legjitime. Numri dy i kësaj force, sekretari i Përgjithshëm, Gazmend Bardhi në një intervistë për "Gazetën Shqiptare" shprehet se nuk do të pranohet asnjë lloj zgjidhje e situatës aktuale politike nëse Edi Rama nuk largohet nga qeveria. Ai ka theksuar se PD nuk i ka bojkotuar zgjedhjet vendore, pasi sipas tij zgjedhje me Ramën kryeministër nuk do të ketë. Ai ka komentuar edhe zhvillimet e fundit politike në kampin opozitar, ku po lind një parti e re me të larguarit nga Partia Demokratike. Sipas tij PD nuk shqetësohet për asnjë forcë që krijohet si shtojca të forcave të tjera apo që nuk përfaqësojnë asnjë vlerë.

Intervista/Numri dy i PD-së përjashton çdo lloj zgjidhje që lë Ramën kryeministër

Bindja Demokratike? Bardhi: Nuk na shqetësojnë shtojcat e partive ekzistuese

"Demokratët nuk kanë qenë asnjëherë tjetër më të bashkuar"



Sekretari i Përgjithshëm i PD-së, Gazmend Bardhi

PARTIA E RE
"Asnjë parti politike ekzistuese apo që mund të krijohet në të ardhmen nuk e shqetëson Partinë Demokratike. Partitë politike krijohen si përfaqësim vlerash dhe programesh, jo si shtojca të partive ekzistuese apo për motive që nuk përfaqësojnë interesin e qytetarëve"

ISH-MINISTRI

Manjani: Bindja Demokratike kërkon t'i japë oksigjen qeverisë

Ish-ministri i Drejtësisë Lylili Manjani ka komentuar dje nismën e Rudina Hajdarit për krijimin e një partie të re politike si një alternativë për përfaqësimin e qytetarëve. Nëpërmjet një komenti në rrjetin social 'Facebook', Manjani ironizon partinë që ka paralajmëruar të krijojë Rudina Hajdari, duke theksuar se kjo forcë që po lind kërkon t'i japë oksigjen qeverisë. "Krijohet parti e re. Quhet: Bindja Demokratike. Përbëhet prej demokratësh të bindur. Qëllimi: T'i jepet edhe pak oksigjen qeverisë. Motivi: Për inat të Lulit. Objektivi: Kap ç'kapësh. Financohet nga: "sekret". Koha e themelimit: shpejt e shpejt sa nuk ka ndërruar mendje PD. Selia: Godina e Kryeministrit. Programi: Në hartim e sipër (coming soon) në varësi të situatës. Slogani: Opozitë e bindur e tigani plot", - shkroi Manjani duke lënë të kuptohet qartë se Partia Bindja Demokratike që po krijohet nga Rudina Hajdari është e iniciuar me mbështetjen e qeverisë si një alternativë që kërkon të mbivendoset dhe të neutralizojë opozitën e vërtetë. Por sipas Manjanit një zgjidhje e tillë nuk mund ta shpëtojë qeverinë. "Mirë ata që janë 'bindur' nuk e kuptojnë dot se ku janë, po qeveria vërtetë beson se do mbijetojë me ta! Unë mendoj se jo...", - shprehet Manjani.

Z. Bardhi, prej më shumë se dy muajsh opozita gjendet jashtë Kuvendit, ndërsa në mënyrë të vazhdueshme është duke protestuar në rrugë. Në momentin që vendosët të digjnit mandatet dhe të dilnit në rrugë e kishit menduar se një situatë e tillë do zgjaste kaq shumë? Pse kemi tejzgjatje dhe jo zgjidhje të krizës politike?

Shqipëria prej kohësh është në krizë politike dhe institucionale, krizë e krijuar përpara se opozita të merrte vendimin unanim për dëgjimin e mandateve. Shqipëria është i vetmi vend në botë, që prej më shumë se 1 viti është pa Gjykatë Kushtetuese, pa Gjykatë të Lartë, pa Prokuror të Përgjithshëm kushtetues, me një parlament të shndërruar në shtojcë të një qeverie të korruptuar; me media që kërcënohet nga kontrolli qeveritar dhe ndërhyrja e parave të kimit dhe korrupsionit. E gjithë kjo situatë ka një përgjegjës, që është Edi Rama dhe vullneti i tij për të ardhur dhe mbajtur pushtet, përmes bashkëpunimit me krimin e organizuar. Për pushtetin e tij personal, Edi Rama është i gatshëm të marrë peng të ardhmen europiane të Shqipërisë. Pa largimin e tij, s'ka dhe nuk mund të ketë zgjidhje të krizës, s'ka stabilitet dhe mirëqenie për shqiptarët.

A ka tratativa nga ana e PD-së për një marrëveshje me PS, dhe me çfarë kushtesh mund të ulet opozita në bledime me qeverinë?

Nuk ka dhe nuk do ketë asnjë tentativë për marrëveshje, me asnjë parti politike, që nuk distancohet nga bashkëpunimi me krimin e organizuar në zgjedhje. Kusht i panegociueshëm për negociatë mes partive politike, është largimi i njeriut që shndërroi Shqipërinë në narko-shtet dhe Qeverinë e

PËR MARRËVESHJEN

"Nuk ka dhe nuk do ketë asnjë tentativë për marrëveshje, me asnjë parti politike, që nuk distancohet nga bashkëpunimi me krimin e organizuar në zgjedhje. Kusht i panegociueshëm për negociatë mes partive politike, është largimi i njeriut që shndërroi Shqipërinë në narko-shtet dhe Qeverinë e tij në avokate të kriminit të organizuar".

tij në avokate të kriminit të organizuar.

Kreu i PD-së, Lulzim Basha ka kërkuar shtyrjen e zgjedhjeve vendore dhe zhvillimin e tyre bashkë me zgjedhjet e parakohshme për pushtetin qendror. Sipas jush kur duhet të zhvillohen ato?

Zgjedhjet do mund të zhvillohen vetëm pasi të jenë krijuar kushtet që ato të jenë të lira dhe të ndershme. Zgjedhje që diktohen nga krimi, dhe paratë e pista, që deformojnë vullnetin e shqiptarëve, nuk mund të ketë dhe nuk do të ketë.

Ditët e fundit vajza e Azem Hajdarit, ish-përfaqësuese e Partisë Demokratike ka ndërmarrë nismën për krijimin e një force të re politike të quajtur Bindja Demokratike si përfaqësuese e opozitës. A e shqetësojnë PD-në Bindja Demokratike që po krijon Rudina Hajdari? Sa mund të ndikojë kjo parti e re brenda së djathtës?

Asnjë parti politike ekzistuese apo që mund të krijohet në të ardhmen nuk e shqetëson Partinë Demokratike. Partitë politike krijohen si përfaqësim vlerash dhe programesh, jo si shtojca të partive ekzistuese apo për motive që nuk përfaqësojnë interesin e qytetarëve.

hë që ka paralajmëruar bojkot të zgjedhjeve nëse nuk ikën Rama, por në kushte të tilla, a rrezikon PD të shkojë drejt shkrirjes së saj?

Partia Demokratike është sot pjesë e të vetmit institucion legjitim në Shqipëri: qytetarëve. PD ka marrë vendim që zgjedhjeve fasadë, të organizuara nga Qeveria ilegjitime e Edi Ramës, nuk ka për të lejuar. Ky nuk është bojkot i zgjedhjeve, sepse zgjedhje me Edi Ramën kryeministër nuk ka për të patur. PD ka marrë përsipër përgjegjësitë e veta, për të mundësuar shqiptarëve, zgjedhje të lira dhe të ndershme. Sot, PD dhe opozita, janë shumicë morale dhe politike në vend. Qytetarët çdo ditë e më shumë po

shkruaj se shpejti me aleatët?

Një marrëveshje parimore për garantimin e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme; për çrrënjosjen e kriminit, korrupsionit, dhe çlirimin e ekonomisë nga oligarkia dhe krimi që po shkatërojnë punësimin, investimet dhe mundësitë për shqiptarët; për vijimin e aksionit opozitar për plotësimin e këtyre objektivave, përfshirë, mandatin dhe detyrat e Qeverisë Tranzitore dhe platformën dhe bashkëpunimin për zgjedhje të lira dhe të ndershme.

A ekziston frika se brenda opozitës së bashkuar do të ketë parti që do hyjnë në zgjedhje, p.sh. LSI?

Të gjitha partitë e koalicionit opozitar; përfshirë LSI, kanë marrë vendim që të regjistrohen në zgjedhje vetëm pasi të jenë krijuar kushtet për zgjedhje të lira dhe të ndershme.

Mos regjistrimi në KQZ është vendim përfundimtar i PD-së për bojkot të zgjedhjeve pasi afati i fundit është dita e martë?

PD ka marrë vendim që zgjedhjeve fasadë, të organizuara nga qeveria ilegjitime e Edi Ramës, nuk ka për të lejuar. Ky nuk është bojkot i zgjedhjeve, sepse zgjedhje me Edi Ramën Kryeministër nuk ka për të patur. Ky është vendim përfundimtar, për të cilin PD dhe opozita nuk bëjnë asnjë hap pas. Çdo hap pas, do të ishte shkatërrimtar për demokracinë dhe zgjedhjet e lira e të ndershme. Do të ishte një mundësi e humbur për Shqipërinë dhe rrugëtimin e saj europian. Për këtë arsye, vendimi është përfundimtar dhe i pakthyeshëm.

PËR 'BINDJEN'

"Nuk kam asnjë interes të di apo vlerësoj se kush fshihet pas krijimit të partive të reja. Ajo që unë di me siguri është që demokratët nuk kanë qenë asnjëherë tjetër më të bashkuar dhe angazhuar se sot, për të çuar përpara ëndrrën për Shqipërinë si gjithë Europa, apo për të mbrojtur demokracinë, që shqiptarët e kanë fituar me gjak përpara 30 viteve".

PD vazhdon të qëndrojë larg institucioneve ndërkombëtare si gjithë Europa, apo për të mbrojtur demokracinë, që shqiptarët e kanë fituar me gjak përpara 30 viteve.

PD vazhdon të qëndrojë larg institucioneve ndërkombëtare

kuptojnë se beteja jonë nuk është për pushtet, por për mbrojtjen e demokracisë. Kjo vetëm e forcon Partinë Demokratike dhe opozitën. **Në çfarë konsistojnë marrëveshjet që PD do nën-**

Shitje me Ankand të dyte nga Studio Permbarrimore L.D.C

Shitje me Ankand të dyte nga Studio Permbarrimore L.D.C
"Trusall + ndërtesë" me nr. pasurije 286/5/1, vol.3, faqe 36, Zona Kadastrele, 3866, me sipërfaqe totale 300 m2, regjistruar ne Z.V.R.P.P. Tirane. Cnimi fillestar per shitje eshte 1.800.000 Leke.
Data e shpalljes 27.02.2019
Data e zhvillimit 28.03.2019 deri ne oren 16.00
Ankandi zhvillohet ne ambientet e Studios Permbarrimore L.D.C me adrese Rruga "Myslym Shyriq" Vila 8/1, kati 1 Tirane.

PASHKA URIMET

Arqipeshkvi Frendo: Është në krizë shpresa për të ardhmen

Dhjetëra qytetarë e besimtarë të krishterë mbushën katedralen e Shen Palit në kryeqytet, nga ku Arqipeshkvi Geroge Frendo, përcolli mesazhe të forta për njerëzit por dhe për klasën politike në vend. Ai bëri apel për më shumë kurajo përballë sfidave në të cilat Shqipëria gjendet sot. Duke iu drejtuar besimtarëve, Imzot George Frendo u bëri një apel politikanëve që të gjejnë sa më shpejt një zgjidhje, për të parandaluar "vetëvrasjen e kombit". "Po kremtojmë Pashkët në një moment kritik dhe të tensionuar. Unë dua Shqipërinë dhe shqiptarët. U bëj apel që të gjithë politikanëve që kanë



detyrë që të angazhohen në zgjedhje të drejta dhe të shqetësohen më shumë të shqiptarët. Sa më shumë të zgjasë, aq më të mëdha do të

jenë pasojat. Nuk duam vetëvrasjen e kombit. Atë që merren me ndjenja hakmarrjeje, Krishti ju thotë "falini". Atyre që protestojnë me

shumë, Jezusi tha "ata që përdorin shpatën, nga shpata do të vdesin". Ngjallja e Krishtit na jep shpresë dhe shpresa nuk na bën optimist, por realist dhe na jep kurajo për të zgjidhur probleme. Gëzuar Pashkët", - tha Imzot George Frendo. Në mes të traditave, imzot Frendo tha se ngjarjet që janë përcjellë në media kohët e fundit e kanë futur në krizë shpresën për të ardhmen. Ngjallja e Krishtit është festa më e rëndësishme për të krishterët dhe themeli i gjithë besimit të tyre.



Gjatë një seance parlamentare

Kisha Katolike nuk priti urimet e politikanëve me rastin e ditës së Pashkës

Komuniteti katolik ka festuar djë në gjithë botën festën e Pashkës. Kjo ditë e shënuar për kalendarin e festave katolike u kremtua edhe në Shqipëri, ku besimtarët ndoqën nga afër mesazhet e dhëna për këtë ditë, ndërsa uruan njëri-tjetrin për më shumë begati. Por ashtu siç e ka bërë tashmë zakon Kisha Katolike në Shqipëri nuk priti vizitat dhe urimet e politikanëve shqiptar, çka detyroi këta të fundit që urimet e tyre t'i përcjellin nëpërmjet rrjeteve sociale. Kreu i shtetit përcolli mesazhin e tij me rastin e kësaj dite që në mbremjen e së shunës, duke theksuar se kjo festë është një mundësi reflektimi për të gjithë jo vetëm për besimin ndaj Zotit, por edhe për të rritur frymën e bashkëpunimit dhe mirëkuptimit ndaj njëri-tjetrit. "Festa frymëzuese e Pashkëve është një moment reflektimi. Kjo ditë e shenjtë na ofron sërish mundësinë që secili prej nesh të përmblidhet detyrat e përgjegjësitë e veta, jo vetëm para Zotit, por edhe ndaj njëri-tjetrit, çdo ditë e pareshur, duke u përpjekur që krahas bashkëjetesës së shkëlqyer fetare, t'i vërtetojmë botën e familjes europiane se vlerat e vjera të kombit tonë me të cilat krenohemi, triumfojmë mbi egon dhe interesat personale të secilit prej nesh. Jam i bindur se shqiptarët gjithmonë kanë pasur afërsinë e mençurinë, por edhe kanë ditur të gjejnë mirëkuptimin e të forcojnë bashkëpunimin për hir të interesit kombëtar", u shpreh meta në mesazhin e vet. Siç e ka kthyer tashmë në traditë kryeministri Edi Rama ka uruar të gjithë besimtarët katolikë për Pashkët, nëpërmjet rrjeteve sociale. Me anë të një foto të Memori-



Kreu i PD-së, Lulzim Basha

alit në Kuvendin e Troshanit, ku mësoi, u rrit dhe dha më pas dha mësim At Gjergj Fishta, Rama i ka uruar të gjithë besimtarëve: Gëzuar Pashkët. "Me këtë pamje të Memorialit në Kuvendin e Troshanit, ku mësoi, u rrit dhe dha më pas mësim At Gjergj Fishta, ju uroj Pashkët të Gëzuar", - shkroi Rama. Po ashtu rrjetet sociale ka zgjedhur dhe Lulzim Basha,

por ky i fundit me një urim nga Kisha e Shenandout në Laç. Kryedemokrati nuk ka kursyer që nëpërmjet këtij urimi të përcjellë edhe disa mesazhe politike. "Kjo ditë e ngjalljes së Krishtit, në të cilën sot, nga kisha e Shna Ndout lutem për të gjithë bashkëqytetarët e mi, në veçanti, për ata që më në nevojë, për të vobekët, për të sëmurët dhe familjarët e tyre,

për ata që vuajnë padrejtësitë. Lutem që kjo ditë e ngjalljes së Krishtit të jetë dita e ngjalljes së shpresës dhe besimit tek paqja dhe e nesërmja e sigurtë, nën drejtimin e Zotit fuqiplotë", tha Basha

Basha: Zoti të na e ndriçojë rrugën e bashkimit kundër padrejtësive

Kryeministri Rama ka uruar nga vendi ku u rrit At Gjergj Fishta

EKSPOZITA

"Kjo ditë e ngjalljes së Krishtit, në të cilën sot, nga kisha e Shna Ndout lutem për të gjithë bashkëqytetarët e mi, në veçanti, për ata që më në nevojë, për të vobekët, për të sëmurët dhe familjarët e tyre, për ata që vuajnë padrejtësitë. Lutem që kjo ditë e ngjalljes së Krishtit të jetë dita e ngjalljes së shpresës dhe besimit tek paqja dhe e nesërmja e sigurtë, nën drejtimin e Zotit fuqiplotë", tha Basha

gjithë si vëllezër e motra, nën Perëndinë, nën Zotin, në këtë ditë të ngjalljes së Krishtit dhe ngjalljes së shpresës, për një Shqipëri të paqes, për një Shqipëri të së ardhmes me të mirë për çdo familje, për çdo shqiptar dhe për të gjithë bijtë, vogëlushët e shqiptarëve. Zoti e bekoftë Shqipërinë!", - u shpreh Basha në mesazhin e tij. Nga rrjeti social 'Facebook' ka zgjedhur të urojë edhe kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj. Ai uroi besimtarët katolikë për këtë ditë të shënuar në kalendarin e krishterë, ndërsa theksoi se ditë të tilla duhet t'i shërbejnë kujtdo për të krijuar bindjen se e mira e mund të keqen dhe dashuria e mund urrejtjen. "Gëzuar festën të gjithë besimtarëve! Qoftë një ditë frymëzimi për këdo se jeta e mund vdekjen, dashuria e mund urrejtjen, optimizmi e mund cinizimin! Bekime e përgafime!", uroi Veliaj në mesazhin e tij.

Berisha: Vendi në udhëkryq, Pashka tjetër ta gjejë më mirë

Urimeve në këtë ditë të veçantë për të gjithë besimtarët katolikë, iu bashkua edhe ish-kryeministri Sali Berisha. Teksa publikonte një foto së bashku me bashkëshorten e tij, Liri Berisha, ai është shprehur se festa e Pashkëve të shërbejë për t'i dhënë shqiptarëve besimin për të zgjidhur udhëkryqin, në të cilin sipas tij ndodhet Shqipëria. "Të dashur miq, sot të krishterët katolik shqiptarë dhe të gjithë botës festojnë Pashkën, ditën e ringjalljes së Krishtit Mbret. Kjo ditë e bekuar i ka gjetur kësaj radhe Shqipërinë, besimtarët katolikë dhe miqtë e tyre të besimeve të tjera në një udhëkryq tejet të rrezikshëm. Por Pashka, dita e ringjalljes së Hyjit është për çdo njeri, për të gjithë besimtarët, ditë e besimit të madh të Zoti, të mirësisë dhe gjithëfuqia e tij. Pashka është ditë e shpresës së pashuar, e frymëzimit të njeriut nga vlerat hyjnore dhe njerëzore dhe një e ardhme më e mirë. Duke ju uruar të gjithë besimtarëve katolik këtë ditë të shenjtë, ju ftoj të dashur miq t'i lutemi në Zotit që të bekojë Shqipërinë, shqiptarët kudo që janë dhe Pashkën tjetër më mirë ta kremtojmë", - shkroi Berisha në urimin e tij.

Shoqëria përparimtare JUSTITIA

Shoqëria përparimtare JUSTITIA shtabi ankandin, faza e para, për shitjen e pasurisë së paluajtshme për të cilën ka vënë hipoteke ABI BANK, me këto të dhëna:
 "Ara", me sipërfaqe 5,130 m², me adresë në Piraç, Lezhë, në Zonën Kadastrale Nr. 2964, me Nr. Pasurie 2019, Vot. 1, fq. 127, në pronësi të znj. Alma Luigj Marku.
 Në vlerën 2.480.000 (dy milion e katërqind e tetëdhjetë mijë) Lekë.
 "Njësi", me sipërfaqe 191 m², me adresë në Lagjen "Besëlidhja", Lezhë, në Regjistrin hipotekor Nr. 578, date 28.10.2016, në Zonën Kadastrale Nr. 8632, me Nr. Pasurie 4/400-N11, në pronësi të Shoqërisë ENCO GROUP-sh.p.k.
 Në vlerën 107.200 EUR (njëqind e shtatë mijë e dyqind) EUR.
 Ankandi zhvillohet në datën 03.05.2019, në përfundim të orarit zyrtar, ora 16:30 në zyrën e përbaruesit gjyqësor me adresë Bulevardi "Bajram Curri", Pall. 21, Shk. 3, Ap. 18, Tiranë.



Zbardhet diskutimi në mbledhjen me dyer të mbyllura në Konferencën e Kryetarëve

Strategjia e PS, paketa e ligjeve në drejtësi miratohet para negociatave

Balla ka kërkuar që ligjet të votohen në 8 maj

Pak para propozimit të Komisionit Europian për hapjen ose jo të negociatave për anëtarësimin në Shqipëri, socialistët parashikojnë që të miratohet edhe paketën e dytë të ligjeve që lidhen me reformën në drejtësi. Në mbledhjen me dyer të mbyllura të Konferencës së Kryetarëve, kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, Taulant Balla ka kërkuar që këto ligje të miratohen që në seancën e datës 8 maj, që sipas tij përkon edhe me prag Ditën e Europës që është në 9 maj, ku Shqipëria raporton për përbushjen e paketës së dytë të reformës në drejtësi. Kuvendi ka zbardhur procesverbalin e kësaj mbledhje, ku kreu i deputetëve socialistë theksojnë se e gjithë paketa e dytë e ligjeve të reformës në drejtësi të kalojë për miratim para Ditës së Europës. Natyrisht që Reforma në Drejtësi mbetet një nga kushtet kryesore që BE e ka vendosur Shqipërisë sa i përket hapjes së negociatave të anëtarësimit. Po ashtu një tjetër kusht që socialistët kanë vendosur po ashtu ta plotësojnë është edhe miratimi i ndryshimeve në Kodin Zgjedhor. Kujtojmë këtu që PS ka parashikuar që një pjesë të këtyre ndryshimeve dhe që kanë të bëjnë me reflektimin e rekomandimeve të OSBE-ODIHR t'i miratojë para dhënies së verdiktit për negociatat, ndërsa një pjesë tjetër të ndryshimeve do t'i diskutojë gjatë sesionit të ardhshëm parlamentar.

rrugë elektronike paraprakisht. Projektkalendari përfshin veprimtarinë në komisione dhe në seancë plenare. Në kalendari janë parashikuar 3 seanca plenare, respektivisht data 18 prill, ora 10.00, 25 prill, ora 10.00. Lidhur me seancën e tretë të radhës, i takon të jetë në datën 2 maj, por data 1 maj, e

mërkurë, është ditë pushimi, gjithashtu, edhe data 29 prill, e hënë, është ditë pushimi dhe komisionet kanë në dispozicion vetëm ditën e martë, datë 30 prill për të punuar. Në kushte të tilla propozimi për seancën e tretë bëhet për datën 9 maj, ora 10.00. Lidhur me pikën e tretë në rend ditë, kemi raportimin periodik që

bëjnë shërbimet e Kuvendit lidhur me zbatimin e planit të veprimit të Kuvendit për rekomandimet e Raportit 2018 të Komisionit Europian. Raportimi përfshin periudhën janar - shkurt 2019. Kemi mendime, sugjerime?

Taulant Balla - Jemi dakord me planifikimin e raportimeve. Do të dëshiroja të thosha se për seancën e caktuar në datë 9 maj kemi aktivitetet me rastin e Ditës së Evropës, ndaj seanca plenare të planifikohet për datën 8 maj e mërkurë, ora 10.00.

Ulsi Manja - Lidhur me projektvendimin "Për strategjinë e edukimit ligjor të publikut në Republikën e Shqipërisë", të planifikohet për seancën e radhës, pasi Komisioni i Ligjeve e miratoi sot. Është një nga projektligjet e paketës së dytë të ligjeve të reformës në drejtësi dhe, nëse ka hapësirë, të përfshihet në seancë.

Taulant Balla - Nga planifikimi është se deri në seancën e datës 8 maj ne t'i kemi mbyllur pothuajse tërësisht, pjesën më të madhe të këtyre ligjeve që lidhen me paketën e dytë të Reformës në Drejtësi. Kjo përkon dhe me datën 9 maj që është dita e Europës, ku Shqipëria raporton me krenari për përbushjen e paketës së dytë të Reformës në Drejtësi.

Ulsi Manja - Këtë diskutim e kam bërë edhe me Drejtorinë e Seancës Plenare. Në në datën 9 maj do të duhet të votojmë në Kuvend të tre projektligjet e fundit të paketës së dytë të Reformës në Drejtësi. Njëra u mbyll sot, ndërsa dy të tjerat mbyllen javën që vjen.

Gramoz Ruçi - Bëjmi çdo njëjën në një seancë dhe mos i lini për një seancë të vetme të tëra.

Ulsi Manja - Mund të lëmë për datën 8 maj, njëjën, të fundit.

Taulant Balla - Do t'u kërkoja kryetarëve të komisioneve edhe Zvendëskryetarëve që në takimin e sotëm të Këshillit Kombëtar të Integritimit në përbushje dhe të detyrës specifike të secilit, të jeni të gjithë prezent, po të kemi parasysh çështjet shumë të rëndësishme që Këshilli Kombëtar i Integritimit ka sot në axhendë.



Konferenca e Kryetarëve

Balla në Elbasan: Opozita është si grenza, ne jemi si bletët

Kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, Taulant Balla zhvilloi dje një takim me fermerët të Elbasanit me të cilët diskutoi mbi problematikat që shqetësojnë sot fshatin dhe bujqësinë, si dhe për aplikimet për përfitim dhe subvencionëve. Ai siguroi fermerët për efikasitetin e skemës dhe reduktimin e burokracive dhe kërkoi prej tyre denoncimin e çdo rasti kur punonjësit kërkojnë rryshet për të ndihmuar gjatë procesit të subvencionit. "Arsyeja pse ju kemi mbledhur bashkë, fermerë dhe punonjës shteti është sepse këta duhet të jenë avokatët tuaj, t'ju shërbejnë që tek grumbullimi i dokumentacionit e deri tek marrja e pagesës. Pres sot të drejtoni edhe gishtin e të më thoni që, ky punonjës më ndihmoi të bëja dokumentacionin, por më kërkoi 10 apo 20%, siç ka qenë para dy viteve. Dhe një punonjës i tillë jo vetëm do të hiqet nga administrata e shtetit, por do të çohet për ndjekje penale. Viti 2018 ishte eksperiencia e parë e një ndryshimi rrënjësor. Historia e AZHBR-së ka qenë një histori e zezë, e errët, ku buxheti i vitit 2017 i të gjithë AZHBR-së shkoi në një qark të vetëm", - tha Balla. Më tej ai nuk nguroi të thumbojë edhe opozitën lidhur me protestat dhe sjelljen ndaj institucioneve. "Unë jam i qetë kur informohen sot që janë rreth 500-600 fermerë të Elbasanit që janë përfutues, që janë 0.7 milionë euro, që i bie diku tek 900 milionë lekë të vjetra të shpërndara te fermerët tanë dhe kjo është një gjë shumë e mirë. Detyra jonë kjo është, Shqipëria e vërtetë kjo është. Nuk është Shqipëria ajo që mbledhet një herë në muaj dhe bën xhiron e pasdites, pastaj hedhin ca bojë tek institucionet e shtetit, atë punë kanë ata. Ata janë grenzat, ne jemi bletët, nga grenzat nuk ka hajër njëri, ne të merremi me bletët", - tha Balla.



Balliu: Marrëveshje me PS për krizën vetëm pasi të iki Edi Rama

Banorët e Unazës së Re, festa e Pashkës i ka gjetur në protestë, në muajin e gjashtë të qëndrës së përditshme. Banorët edhe dje kanë kundërshtuar projektin që i prish atyre banesat ndërsa kanë shqiptuar qeverinë, si përgjegjëse për situatën e krijuar nëpërmjet aferave të ndryshme korruptive që shoqëruan këtë projekt. Ish-deputeti i Partisë Demokratike, Klevis Balliu, paralajmëroi se të gjithë shqiptarët gjenden në rrezik dhe në të njëjtin hall, si banorët e Unazës së Re, për shkak të qeverisjes me arrogancë nga ana e socialistëve. "Hall më të zi se të të vinë tek dera e shtëpisë e të të nxjerrin nga shtëpia nuk ka. Uroj që ajo që u ka ndodhur këtyre qytetarëve, të mos i ndodhë asnjërit tjetër. Në qeverisjen e PD, halle si këto nuk do t'i kenë kurrë më. Zgjedhje të pandershme prodhojnë qeveri të cilat mbështesin projekte mafioze, si ai i Edmond Begos", tha Balliu. Më tej ai theksoi se opozita nuk do të bëjë kurë marrëveshje me Ramën në kurriz të interesave të shqiptarëve. "Qeveri të dala nga këto zgjedhje nuk merren me qytetarët, por shohin interesat e hajdutëve. Nëse duam ta bëjmë Shqipërinë, fillohet nga zgjedhjet e lira, ju garantoj se marrëveshje me kriminelin si Edi Rama nuk bëjmë. Diskutimet fillojnë kur Edi Rama ikën. Ju garantoj se nuk ka fuqi, as Edi Rama, as Erion Velaj, të ndalojë çka kemi nisur, revoltën mbarëkombëtare. Nuk do të ketë mundësi që Edi Rama të rikthejë zgjedhjet e Enver Hoxhës më 30 qershor", - tha Balliu.

NJOFTIM ANKANDI

1. Shoqëria e Përbarimit "BALLIFF SERVICE E.HOXHA" sh.p.k. njofton Shpalljen e Ankandit të II (Dytë), për shitjen e pasurisë së paluajtshme: Njësi, me sip. 142 m², Zona Kadastrale: 2640, Numri i Pasurisë: 496/386+3+M2, Vol. 52, Fage 239, ndodhur në Linzë Dajti, Tiranë, në pronësi të: Shoqërisë "AGLI" sh.p.k. identifikuar me NIPT: J71702004M. Ankandi i pasurisë fillon me gminim fillestar në vlerën 4,962,048 (katër milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e dyzet e tetë) LEKË. Ankandi do të zhvillohet më datë 23.04.2019, ora 16:00, pranë zyrës së Shoqërisë së Përbarimit "BALLIFF SERVICE E.HOXHA" sh.p.k., në adresën Rruga "Vaso Pasha" Pallati 131, Ap.1, Tiranë, nr.teléfono 042320227, email: elvinth@hotmail.com.

NJOFTIM ANKANDI

1. Shoqëria e Përbarimit "BALLIFF SERVICE E.HOXHA" sh.p.k. njofton Shpalljen e Ankandit të I (Parë), për shitjen e pasurisë së paluajtshme: Garazh, me sip. 96 m², Zona Kadastrale: 2640, Numri i Pasurisë: 199/32-G3, Vol. 45, Fage 169, ndodhur në Linzë Dajti, Tiranë, në pronësi të Shoqërisë "AGLI" sh.p.k. identifikuar me NIPT: J71702004M. Ankandi i pasurisë fillon me gminim fillestar në vlerën 1,893,120 (një milion e tetëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e njëqind e njëzetë) LEKË. Ankandi do të zhvillohet më datë 26.04.2019, ora 16:00, pranë zyrës së Shoqërisë së Përbarimit "BALLIFF SERVICE E.HOXHA" sh.p.k., në adresën Rruga "Vaso Pasha" Pallati 131, Ap.1, Tiranë, nr.teléfono 042320227, email: elvinth@hotmail.com. Ankandi të publikohet nga data 22.04.2019 deri më 26.04.2019



SHOQËRIA PËRBARIMORE GJYQËSORE "3H" Sh.p.k.
Rr. "Fah Data", Kompleksi Roka 2, Kulla 5, Kt. 1, Tiranë
Web: www.3h.sh; Email: shqgj_3h@yahoo.com cel:0692009711

Njofton shpalljen e ankandit nga dt.16.04.2019 deri ne dt. 24.04.2019 per: sendin e luajtshem- autometjin terheqes Renault me Targa AA 245 OE, model Magnum 480 me cmin fillestar 751,800.00 Leke autometjin gjysem riorjko marka Fruehauf TD 35, me Targa AER 831 me cmin fillestar 98,800.00 Leke ne pronesi te Subjektit Klodian Xhani PF me NIPT L02025004L. Ankandi zhvillohet ne zyrën përbarimore ne daten 24.04.2019 dhe mbyllet me orarin zyrtar 16.00

Frroku: Kërkuan të na i blinin 40 milionë por kurrë s'menduan biznesin

Si u ruajtën kambanat e kishës së Shmisë nga familja Thekna

Gjergj Thekna: I gjeta në përrua e i fsheha deri në 91-shin

Pak kush e di që në Kishën e Shmisë, në fshatin breg të Pukës kambanat janë që prej ndërtimit të parë të Kishës. Tingujt e tyre që ndalën për 40 vite u rikthyen sërish me kthimin e besimit fetar. Ishin vetë besimtarët që u kujdesën t'i varrosnin gjërat e Kishës, të cilat në fillim-vitet e tranzicionit erdhën të ngjashme me vetë historinë e Krishtit të ringjallur pas varrosjes.

Gjergj Thekna, sot 85 vite është ai që ruajti dy kambanat e hershme të Kishës së fshatit Breg. Gjergji tregon se askush nga fshati nuk e dinte se ai kishte fshehur kambanat, madje as një pjesë e familjes së tij, deri kur ai bashkë me të birin vendosën t'i nxirrin pas rrëzimit të regjimit diktatorial. "Kambanën e madhe e gjeta në përrua e ngarkova në plug dhe e çova në shtëpi. Më pas e fsheha në oborr pastaj e groposa dhe hupi (humbi) krejt. Ngaqë doli puna e fesë e nxora në oborr me e pa, pastaj e lava mirë e më pas e solla në kishë"- thotë 85 vjeçari. Historinë e mbijetesës së kambanoreve e përjetojnë me emocion dhe djemtë e Gjergjit. Frroku, një prej bijve të Gjergjit, tregon se si familja e tij refuzuan në vitin '92, 40 milionë lekë që ju ofruan në këmbim të kambanave, të cilat kanë pjesë prej ari. "Baba me gjithë vëllain e madh i morën dhe i sollën kambanat në shtëpi. Ato rrezikonin shumë, sepse po ta kapnin me to, më e pakta që e priste ishte burgu. Edhe në familje disa nuk e dinin. I maskoi mirë e në



RUAJTJA E KEMBANAVE

Gjergj Thekna, sot 85 vite është ai që ruajti dy kambanat e hershme të Kishës së fshatit

Breg. Gjergji tregon se askush nga fshati nuk e dinte se ai kishte fshehur kambanat, madje as një pjesë e familjes së tij, deri kur ai bashkë me të birin vendosën t'i nxirrin pas rrëzimit të regjimit diktatorial.

"Kambanën e madhe e gjeta në përrua e ngarkova në plug dhe e çova në shtëpi. Më pas e fsheha në oborr pastaj e groposa dhe hupi (humbi) krejt. Ngaqë doli puna e fesë e nxora në oborr me e pa, pastaj e lava mirë e më pas e solla në kishë"- thotë 85 vjeçari.

vitin 1991 kur u hap besimi fetar, ai i nxori nga i kishte fshehur dhe na i tregoi. U befason të gjithë, priftërinj, ipeshkv, se si ai i kishte ruajtur kambanat.

Para se t'i dërgonte në kishë, na vinin njerëz që të na i blinin me 40 milionë lekë, por ne nuk bëmim tregti me kambanat e kishës", tregon Frroku dja-

Historinë e mbijetesës së kambanoreve e përjetojnë me emocion dhe djemtë e Gjergjit. Frroku, një prej bijve të Gjergjit, tregon se si familja e tij refuzuan në vitin '92, 40 milionë lekë që ju ofruan në këmbim të kambanave

li i Gjergjit. Histori të tilla, si kjo e Gjergj Theknas nga fshati Breg tregojnë forcën e besimit që të krishterët kishin edhe në kohën e diktaturës, besim që shpesh ishte më i fortë se pasojat që mund të prisnin besimtarët nga regjimi totalitar.

"Range Rover-i" përplasat me dy autobusë të linjës Korçë-Kapshiticë

Një aksident është regjistruar këtë të diel në segmentin rrugor Korçë-Kapshiticë, në vendin e njohur si kryqëzimi i Plasës. Gazetarja Lorena Kodra raporton për "BalkanWeb" se në aksident janë përfshirë një mjet tip Range Rover dhe 2 autobusë, të linjës Korçë-Kapshiticë. Burimet paraprake të policisë thonë se fatmirësisht nga përplasja nuk ka persona të dëmtuar, por vetëm dëme materiale. Po sipas tyre, dyshohet se ka qenë automjeti ai që i ka prerë rrugën autobusëve. Policia po kryen hetimet e nevojshme.

E rëndë në Tiranë, plagoset 26-vjeçari me armë zjarri

TIRANË Një ngjarje e rëndë mësohet të ketë ndodhur para pak minutash në Tiranë, në zonën e Mëzezit, ku një 26 vjeçar është plagosur me armë zjarri.

Gazetarja Dorjana Bezat raporton për "BalkanWeb" se i riu menjëherë pas plagosjes ka shkuar për ndihmë mjekësore. Mësohet se i riu nuk ka pranuar të bashkëpunojë me policinë. Ai nuk ka treguar nëse bëhet fjalë për vetëplagosje apo plagosje.

Tiranë/ Informacion paraprak

Rreth orës 18:35, ka shkuar për ndihmë mjekësore në spital shtetasi E. M., 26 vjeç, jashtë rrezikut për jetën, i cili është plagosur në këmbë me armë zjarri, i në rrethana ende të paqarta në rrugën "Asdreni" në Fushë Mëzëz, Kashar. Shërbimet e policisë po punojnë për zbardhjen e rrethanave të ngjarjes, identifikimin dhe kapjen e autorit/ve.

unicef for every child
UNITED NATIONS CHILDREN'S FUND (UNICEF)
Albania Country office

CALL FOR EXPRESSION OF INTEREST - EOI-ALBA-2019-002

The UNITED NATIONS CHILDREN'S FUND (UNICEF), ALBANIA Country Office, would like to announce a Call for Expression of Interest addressed to Civil Society Organizations (CSOs) for a prospective partnership with UNICEF Albania Country Office in the implementation of the activity

"Improving the nutrition status of school age children in Albania"

For further details on the required partnership and on how to respond to the Call, please consult UNICEF Albania (<https://www.unicef.org/albania/suppliers-and-service-providers>) and UN Albania (<http://www.un.org.al/employment-and-procurement>) websites.

Applications from interested CSOs must be delivered to UNICEF Tirana Office not later than **13 May 2019, at 16:30 hr.**

Applications must be submitted in a sealed envelope, clearly marked **"Call for Expression of Interest - EOI-ALBA-2019-002 - Improving the nutrition status of school age children in Albania"**, at the following address:

United Nations Children's Fund (UNICEF)
Rruga "Skënderbej", ndërtesa e Agjencive të OKB-së, kati i tretë,
Tiranë, Albania
Tel.: + 355 4 454 8400
Website: www.unicef.org/albania

Telefonata në "News24" vuri në lëvizje ekipet e ndihmës

Pesë vetë mbetën të bllokuar për 3 orë në kanionet e Erzenit

Një grup prej 5 personash mbetën të bllokuar të dielën të paktën 3 orë në shpellën e Pëllumbasit, në kanionet e Erzenit. Në një telefonatë për "BalkanWeb" një nga personat e mbetur të bllokuar tha se së bashku me miqtë e tij kishin shkuar për ngjitje, kur njëri nga ata ndrydhi këmbën. Urgjencia mjekësore dhe policia ndodhen në vendngjarje, ndërkohë ndërhyrja është e pamundur për shkak të terrenit të vështirë. Pritet ndërhyrja



e zjarrfikëses. Personi që ndrydhi kavigjën mësohet të jetë 42 vjeçari, Gazmend Bugalli, i cili raportohet të jetë në gjendje të rënduar. "Po na mbaron bateria. Është e vështirë lëvizja me barrelë e të sëmuri"-, u shpreh në telefonatë, një nga anëtarët e grupit të mbetur të bllokuar. Ai tha se po i mbarojnë edhe lëngjet e marra me vete, ndërsa kërkoi që të bëhet ndërhyrja nga ajri për faktin që është e vështirë lëvizja me barrelë e të sëmuri.

Oficerët e Prokurorisë për Krimet e Rënda zbarkojnë në zyrat e Aviacionit Civil

Grabitja e Rinasit, në pranga dy vetë

Furgoni i "Hetimit Tatimor" u modifikua në Elbasan

ELBASAN

Dy persona janë ndaluar sot nga policia si të lidhur me grabitjen në aeroportin e Rinasit. Burime për "Gazeta Shqiptare" bëjnë me dije se mendohet që ata kanë modifikuar furgonin e Rinasit, me mbishkrimin "Hetimi Tatimor". Ata dyshohet se kanë lidhje me persona që akuzohen për disa krime të ndodhura në vendin tonë si edhe jash-të Shqipërisë. Ndalimi i dy shtetasve nga Elbasani pritet të hedhë dritë për identifikimin e personave që dyshohet se janë të përfshirë në grabitjen e Rinasit. Njëri nga të dyshuarit u ndalua në lagjen '28 Nëntori', i dyshuari tjetër u ndalua në periferi të qytetit.

Dy të ndaluarit mësohet të jenë të moshës 28 dhe 29 vjeç. Në një lidhje telefonike për News 24 gazetaria Klodiana Lala u shpreh se të ndaluarit janë shoqëruar që në orët e para të mëngjesit nga policia, ku edhe janë marrë në pyetje. Duhet theksuar se policia dhe prokuroria kanë në vëmendje persona të tjerë me të shkuar kriminale. Nëse konfirmohet nga policia se janë grabitur 10 milionë euro do jetë grabitja më e madhe e ndodhur në 29 vite.

HETIMI

Pas 12 ditë hetimesh, policia dhe Prokuroria e Krimeve të Rënda kanë zbuluar servisn ku është modifikuar furgoni me mbishkrimin "Hetimi Tatimor", që u përdor nga Admir Murataj dhe bashkëpunëtorët e tij në grabitjen e 6.5 milionë eurove në pistën e Aeroportit të Rinasit. Burime nga grupi hetimor konfirmuan se ky servis ndodhet në Elbasan dhe policia ka marrë në pyetje pronarin për të bërë të mundur identifikimin e atyre që e kanë porositur modifikimin. Ndërsa oficerët e Prokurorisë për Krimet e Rënda kanë zbarkuar në zyrat e Aviacionit Civil. Pranë këtij institucioni ditët e fundit janë sekuestruar të gjitha kontratat që shtetit shqiptar ka me koncesionarin e aeroportit. Ky dokumentacion është duke u këqyruar dhe pas përfundimit të këtij veprimi hetimor, pritet marrja në pyetje e drejtuesve të Aviacionit Civil.3



HETIMI

Hetuesit janë tepër të rezervuar në dhënien e informacionit, por zbulimi i servisit është bërë nga këqyrja e kamerave të sigurisë, nga ku ka kaluar ky mjet. Nuk bëhen të ditura ato që ka deklaruar ky person, por dëshmia e tij është mjaft e vlefshme, pasi nga aty mund të shkohet tek autorët e tjerë. Ky furgon është një minierë për grupin hetimor, pasi autorët aty kanë lënë mjaft prova, nga gjurmë gishtat, deri të fije floku, që mund të shërbejnë për zbulimin e grabitësve.

DESHMITE

Policia gjatë këtyre ditëve ka mbledhur dëshmi dhe të dhëna në disa qytete të vendit, si Tiranë, Elbasan, Fushë-Krujë dhe janë bërë hapa konkretë që mund të çojnë në zbulimin e grabitësve të tjerë. Gjithashtu, edhe për personin, i cili dogji një furgon në afërsi të Bathores, për të shpërqendruar policinë, janë gjetur të dhëna që mund të çojnë në identifikimin e tij. Ndërsa oficerët e Prokurorisë për Krimet e Rënda kanë zbarkuar në zyrat e Aviacionit Civil.

Firmat nuk kanë licenca për të nxjerrë gurë

Aksident në Malin e Tomorit, humb jetën shoferi 36-vjeçar

Edhe pse pa licenca firmat e nxjerrjes së gurit në Malin e Tomorit vijojnë punën. Një aksident i rëndë ka ndodhur sot në Malin e Tomorit, pikërisht në zonën e shpatit të malit, ku ndodhen edhe karrierat e gurit dekorativ. Shoferi i një nga firmave të nxjerrjes së gurit dekorativ, ka humbur kontrollin e mjetit dhe është rrëzuar me kamionin që ishte i ngarkuar me pllaka guri. Si pasojë e aksidentit, 36-vjeçari Besnik Sali Kanani, ka humbur jetën. Viktima 36-vjeç Besnik Kanani, jetonte në fshatin Fushë-Pesh-tan të Poliçanit dhe ishte babai i 3 fëmijëve. Ai punonte prej vitesh si shofer kamioni në firmat e nxjerrjes dhe përpunimit të pllakave e gurit dekorativ në Malin e Tomorit. Edhe pse prej gati një viti Ministria e Mjedisit ka revokuar të gjitha licencat dhe ka pe-



zulluar punën e firmave të nxjerrjes së gurit dekorativ në Malin e Tomorit, firmat vijojnë sërish punën, pa u shqetësuar aspak dhe duke mos përfillur ligjin. Burimet mes punëtorëve të këtyre firmave konfir-

mojnë se, në Malin e Tomorit puna nuk është ndërprerë asnjëherë dhe se vazhdon të nxirren pllaka guri, duke rrafshuar qafën e malit, në fshatrat: Dërvi, Novaj e Nishovë. Eneida Petova

Ngjarja në një bar të Torinos, akuzo tentativë vrasjeje

Godet me thikë pronarin e lokalit, shqiptarit i zbulojnë "zanatin"

Diskutimi midis një 32-vjeçari shqiptar dhe një italiani në një bar në Corso Giulio Cesare, në Torino, përfundoi me një të plagosur. Më dy plagë, në krahë dhe shpatull, pronari i barit u dërgua me urgjencë në spital, ndërsa shqiptari u shpall në kërkim nga autoritetet italiane, por u arrestua pak orë më vonë. Debati ka nisur në 4 prill, pasi shqiptari ka ngacmuar shokun e pronarit të barit dhe më pas ka nisur sherrin ku nuk kanë munguar dhe dëmet në lokal. Ndërsa pronari i barit është takuar për t'u sqaruar, por shqiptari në debat e sipër e ka qëlluar me thikë, duke i shkaktuar dy plagë. Gjatë një kontrolli të ushtuar në banesën ku shqiptari jetonte me vëllain e tij, policia gjeti më shumë se 13 objekte të çmuara të cilat rezultuan se ishin të vjedhura. Gjithashtu, në banesë u gjetën dhe 2800 euro, ku dyshohet se janë përfutur nga vjedhjet që janë kryer nga shqiptari, raportojnë mediat italiane.



Rrezikuan mbytjen, Forca Detare shpëton 2 peshkatarë në Vlorë



Anija "Mati" e Forcës Detare shqiptare shpëtoi 2 peshkatarë në det të hapur, në perëndim të gadishullit të Karaburunit, të cilët kishin dhënë alarmin për ndih-

më. Dy peshkatarët u gjetën 8.8 milje larg Kepit të Gjuhëzës, nga anija e gatshme në ishullin e Sazanit, siç bëjnë me dije burime polico-re. Peshkatarët G.L dhe

A.H dhe mjeti lundruer "Syri 2366", u rimorkiuar pa probleme në Triport. Nuk dihet ende avaria që mund të kenë pësuar ata në det të hapur.

Vlera e investimit është 98 milionë euro me një fluks prej 600 mijë udhëtarësh në vit

Garë ndërkombëtare për aeroportin e Vlorës

Kompanitë turke nuk arritën të marrin miratimin për koncesionin

Ministria e Infrastruktursë dhe Energjisë do të shpallë së shpejti një garë ndërkombëtare për të dhënë me koncesion ndërtimin dhe operimin e aeroportit të Vlorës. Sipas Klan negociatat me kompanitë turke, të cilat shprehën interes për ndërtimin dhe menaxhimin e kësaj veprë, nuk arritën të marrin dritën jeshile. Në shkurt të 2018-s, Kuvendi autorizoi që brenda 90 ditëve grupi negociator me përfaqësues të Ministrisë së Financave dhe asaj të Infrastruktursë, të arrinte një marrëveshje me bashkimin e operatorëve turk, Cengiz; Kalyon dhe Kolin Construction. Marrëveshja nuk arriti të finalizohet, pasi kompania kërkoi që qeveria shqiptare t'i paguajë asaj 4.5 milionë euro në vit për 7 vjet rresht si garanci për fluksin e munguar të pasagjerëve, ndërsa qeveria shqiptare ishte e vendosur që të mos akordonte më shumë se 2.5 milionë në vit. E pyetur zyrtarisht për këtë çështje, Ministria e Infrastruktursë dhe Energjisë shprehet se interesi nga investitorët në këtë aeroport ka qenë i madh, e se gara do të përmbajë kushtet: ndërtim-operim-transferim për kompaninë që do të dalë fituese. Firma që do të ndërtojë aeroportin do të marrë për 35 vjet operimin e tij, e më pas do ta transferojë veprën në pronësi të shtetit shqiptar. Sipas një studimi fizibiliteti, vlera e investimit për të ndërtuar aeroportin e Vlorës është 98 milionë euro, ndër-



98

MILIONE

Vlera e investimit për të ndërtuar Aeroportin e Vlorës është 98 milionë euro, ndërsa në 3 vitet e para mendohet një fluks prej 600 mijë udhëtarësh në vit.

NEGOCIATAT

Sipas Klan negociatat me kompanitë turke, të cilat shprehën interes për ndërtimin dhe menaxhimin e kësaj veprë, nuk arritën të marrin dritën jeshile. Në shkurt të 2018-s, Kuvendi autorizoi që brenda 90 ditëve grupi negociator me përfaqësues të Ministrisë së Financave dhe asaj të Infrastruktursë, të arrinte një marrëveshje me bashkimin e operatorëve turk, Cengiz; Kalyon dhe Kolin Construction.

sa në 3 vitet e para mendohet një fluks prej 600 mijë udhëtarësh në vit. Kontrata e parë e negociuar me kompanitë turke përjashtonte mundësinë e garës për kompani të tjera, ndërsa t-

deri që pritet të zhvillohet, do të përzgjedhë ofertën më të mirë ekonomike. Aeroporti i Vlorës do të ndërtohet në Akërnë, një zonë me distancë 10 minuta larg rrugës kombëtare Fier-Vlorë.

Ministria e Infrastruktursë dhe Energjisë shprehet se interesi nga investitorët në këtë aeroport ka qenë i madh, e se gara do të përmbajë kushtet: ndërtim-operim-transferim për kompaninë që do të dalë fituese. Firma që do të ndërtojë aeroportin do të marrë për 35 vjet operimin e tij, e më pas do ta transferojë veprën në pronësi të shtetit shqiptar.

Dy lagje në kryeqytet do të kenë rrjet të ri ujësjellësi

Banorët e dy rrugëve në kryeqytet nuk do të kenë më probleme me ujë. Ndërmarrja e Ujësijellës-Kanalizimeve ka përfunduar investimin në rrjetin e shpërndarjes në rrugën "Jusuf Vriioni", një investim nga i cili përfitojnë qindra familje. Sakaq, në rrugën "Xhanfize Keko" është vënë në funksion të plotë linja e re e ujësjellësit. Ky investim i Bashkisë në këtë zonë të kryeqytetit ka bërë të mundur një kapacitet të shtuar të furnizimit me ujë të pijshëm, si dhe shërbim cilësor për qytetarët. Gjatë ditëve të fundit, grupet e punës të UKT kanë ndërhyrë edhe në zona të tjera të kryeqytetit, për t'i dhënë zgjidhje çdo problematike të krijuar në çdo cep të Tiranës. Ndërkohë që UKT ka nisur punën për dyfishimin e kapacitetit filtrues në impiantin e Bovillës, si dhe të shtimit të linjës së re të furnizimit me ujë që do shërbejë për zonat periferike



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Shërbimi vjetor i mirëmbajtjes dhe riparimit të ashensorëve në godinat e Bankës së Shqipërisë"

'Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 1,840,000 Lekë**".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 1844), çdo ditë nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Shërbimi vjetor i mirëmbajtjes dhe riparimit të ashensorëve në godinat e Bankës së Shqipërisë"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 14 Maj 2019, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku tohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR I SHOQERUAR
ME FTESA DIREKTE KANDIDATEVE TE HUAJ

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Shtypja e monedhave metalike përkujtimore për qëllime numizmatike '200 Lekë' dhe '100 Lekë', pa kurs ligjor, për nevojat e Bankës së Shqipërisë"

'Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar i shoqeruar me ftesa direkte kandidatëve të huaj", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 54,345,000 Lekë**".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 1844), çdo ditë nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Shtypja e monedhave metalike përkujtimore për qëllime numizmatike '200 Lekë' dhe '100 Lekë', pa kurs ligjor, për nevojat e Bankës së Shqipërisë"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 23 Maj 2019, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku tohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

TRAGJEDIA NË SRI LANKA REAGJOJNË POLITIKANËT SHQIPTARË



Tetë shpërthime në vend, ministri i Mbrojtjes: Janë arrestuar shtatë persona

Përgjaken Pashkët, 207 të vrarë e 450 të plagosur në Sri Lanka

Tragjedia në Kolombo, qeveria bën shtetrrëhim

Mëngjesin e djeshëm të Pashkëve kanë ndodhur tetë shpërthime vdekjeprurëse në tri kisha të Sri Lankës, një prej të cilave në kryeqytetin Kolombo dhe në disa hotele të vendit të frekuentuara nga turistët, duke shkakuar vdekjen e të paktën 207 personave, 35 prej të cilëve të huaj. Numri i të plagosurve deri tani është 450. Në një distancë prej pak orësh në Kolombo kanë ndodhur 2 shpërthime të tjera. Shpërthimi i tetë ka ndodhur në periferi të Kolombos. Një tjetër shpërthim ka ndodhur në kryeqytetin Sri Lanka në Kolombo. Lajmin e bën me dije policia. Ky është shpërthimi i tetë në një ditë dhe ka ndodhur në periferi të Orugodawatta, në veri të kryeqytetit. Ministri i Mbrojtjes ka thënë se janë arrestuar shtatë persona të dyshuar për ngjarjen. 'Përgjegjësit e atentateve në ditën e Pashkëve në Sri Lanka duhen dënuar pa mëshirë'. Kështu ka thënë peshkopi i Colombia, kardinali Malcolm Ranjith, i cili i ka bërë apel qeverisë të hetojë dhe të dënojë pa mëshirë përgjegjësit e sulmit. 'Pa mëshirë sepse vetëm kafshët mund të sillen në këtë mënyrë'. Kisha e Sri Lankës ka ndërprerë të gjitha festimet e Pashkëve të programuara në vend dhe ka shpërndarë një apel për të dhuruar gjak për të plagosurit. Qeveria e Sri Lankës ka vendosur të shpallë gjendjen e shtetrrëhimin nga ora 18:00 me orën lokale (14:30 me orën tonë) deri në 6:00 të mëngjesit të sotëm. Lajmin e bën me dije e përditshmja Navami. Sipas BBC 3 prej shpërthimeve ndodhën në kishat në Kochchikade, Negombo dhe Batticaloa, gjatë kohës që mbaheshin shërbimet e Pashkëve. Hotelet Shangri La, Cinnamon Grand dhe Kingsbury, të cilën ndod-



SHPËRTHIMET

Mëngjesin e Pashkëve në Sri Lanka kanë ndodhur tetë shpërthime vdekjeprurëse në tri kisha të Sri Lankës, një prej të cilave në kryeqytetin Kolombo dhe në disa hotele të vendit të frekuentuara nga turistët, duke shkakuar vdekjen e të paktën 207 personave, 35 prej të cilëve të huaj. Numri i të plagosurve deri tani është 450.

hen në Kolombo, ranë, gjithashtu, pre e sulmeve. Presidenti i vendit Maithripala Sirisena u bëri thirrje njerëzve që të ruanin qetësinë dhe të mbështesnin autoritetet në hetimet e tyre. Ndërsa Kryeministri Ranil Wickremesinghe pritet të mbajë një mbledhje

emergjente. "Dënoj me forcë sulmet mbi njerëzit tanë. U bëj thirrje popullit të Sri Lanka që të qëndrojnë të bashkuar dhe të fortë gjatë këtij momenti tragjik", tha ai. Ministri i Financave, Mangala Samaraweera në një postim në Tëitter tha se sulmet ishin

të mirë koordinuara me qëllim që të krijonin kaos e anarki dhe të vrisnin sa më shumë njerëz të pafajshëm. Deri më tani asnjë grup nuk ka marrë përsipër autorësinë e sulmeve. Kohët e fundit në vend është rritur frika se luftëtarët e Shtetit Islamik, të rikthyer nga Lindja e Mesme mund të kthehen në kërcënim për vendin. Që prej fundit të luftës civile në Sri Lanka, në 2009-n, ka pasur raste sporadike dhune, kryesisht nga anëtarët e komunitetit Budist Sinhala, të cilët në qendër të sulmeve të tyre kanë xhami dhe prona të myslimanëve. Kjo bëri në që Mars të 2018-s në vend të shpallë emergjencë kombëtare.

PRESIDENTI

ILIR META

Për ngjarjen e rëndë ka reaguar edhe Presidenti i vendit, Ilir Meta, i cili përmes një statusi në 'Facebook' dënon sulmin terrorist për shkak të besimit fetar dhe lutet për familjarët e viktimave e të plagosurve. **STATUSI I PLOTE I METËS:** "Një lajm shumë i keq dhe shokues na vjen nga Sri Lanka. Në ditën e Pashkëve, besimtarë të krishterë të pafajshëm janë sulmuar nga terroristë mizor të cilët përdorin besimin fetar për agjandat e tyre politike. Mendimet dhe lutjet e mia janë me familjet e viktimave dhe të lënduarve".



ISH-DEPUTETI I PD

TRITAN SHEHU

Ish-deputeti i PD-së, Tritan Shehu përmes një statusi në 'Facebook', reagoi pas sulmit terrorist të ndodhur në Sri Lanka. Ai e quan sulmin e ndodhur për Pashkë, tepër monstruoz, që godet jo vetëm kristianët, por mbarë njerëzimin. **STATUSI I PLOTË:** Të gjithë keqardhjen për viktimat e shumta në Sri Lanka, përbuzjen e thellë ndaj terrorizmit e radikalizmit. Një krim monstruoz terrorist, mbi bazën e ekstremizmit, radikalizmit, fundamentalizmit, mirë i organizuar e i gjerë, këtë ditë të Pashkëve godet jo vetëm kristianët, por njerëzimin mbarë, vlerat tona universale. Mbi 150 të vrarë në Kisha e hotele të Sri Lankës nga struktura të tilla kriminale, që përdorin emrin e Zotit e Fesë, veçse për qëllime nga më të errëta e antinjerëzore. Të tilla ngjarje konfirmojnë të vërtetën, se beteja e madhe për paqe, demokraci, bashkëjetesë, plurikulture, liri e zhvillim nuk ka përfunduar e është akoma e hapur, pavarësisht se shpesh kamuflohet në forma të ndryshme dhe e keqja tentohet të ofrohet e "sheqerosur".



FEMIJE NDRYSHE PERPJEKJET

INTERVISTA/ Flet drejtuesja e programit "Tungjatjeta" për Librazhdin

Donika Qelemeni: Si ndryshuam jetët e 36 fëmijëve me aftësi të kufizuara

"Plani që ne kemi hartuar përfshin dhe shkollat apo qendrat shëndetësore"

Po mbushet gati një vit që World Vision po zbaton programin "Tungjatjeta", një program social i dedikuar fëmijëve me aftësi të kufizuara, të cilët jetojnë në zonat më të thella të vendit, i nisur në Librazhd, ku i vjen në ndihmë 36 fëmijëve me aftësi ndryshe, të cilët për një seri rrethanash, që nga pamundësia ekonomike e familjeve deri të largësia nga qendrat urbane apo mungesa e strukturave shtetërore, nuk merrnin asnjë lloj shërbimi. Situata për ta ka ndryshuar, dhe drejtuesit e programit mund t'i gëzohen rezultateve të prekshme. "Në fillim ndërtuam planin e zhvillimit për çdo fëmijë. Janë 4 specialiste logopediste, fizioterapiste, psikologe dhe punonjëse sociale, të angazhuara në një punë të përditshme. Sipas programit secili fëmijë vizitohet çdo javë, dhe në këtë vizitë ata, mund të përfitojnë minimumi një deri të tre terapi", tregon drejtuesja e programit "Tungjatjeta" për Librazhdin, Donika Qelemeni.



Psikologja Mimoza Polisi

STATISTIKA

- 70 mijë fëmijë të moshës 2 deri në 17 vjeç, në Shqipëri rezultojnë me një vështirësi të thelluar.
- 92 % e tyre, nuk arrijnë të marrin shërbime të integruara pranë zonave të banimit.
- Vetëm 8% e fëmijëve me aftësi të kufizuara marrin shërbim nga qendrat sociale.

Cila ishte gjendja e këtyre fëmijëve, përpara se ju të nisnit programin?

36 fëmijët që janë përfshirë në projekt nuk ishin në vëmendjen e shkollës apo qendrave shëndetësore. Nuk punonte njeri me programe në përshtatje të nevojave të fëmijës. Kështu, 4 fëmijë që mund të ishin në shkollë, nuk i frekuentonin ato. Ndërsa tani ata ndjekin rregullisht mësimet. Gjithashtu, 5 fëmijë janë regjistruar për herë të parë në kopsht dhe në klasën e parë. Mendoj se pa ndërhyrjen tonë do të ishin në shtëpi.

Ndërhyrja juaj përfshin vetëm punën me fëmijët?

Plani që ne kemi hartuar përfshin dhe shkollat apo qendrat shëndetësore. Disa nga fëmijët shkojnë në sh-



Eva Buzra, specialiste logopede


GJENDJA E FEMIJEVE

36 fëmijët që janë përfshirë në projekt nuk ishin në vëmendjen e shkollës apo qendrave shëndetësore. Nuk punonte njeri me programe në përshtatje të nevojave të fëmijës. Kështu, 4 fëmijë që mund të ishin në shkollë, nuk i frekuentonin ato. Ndërsa tani ata ndjekin rregullisht mësimet. Gjithashtu, 5 fëmijë janë regjistruar për herë të parë në kopsht dhe në klasën e parë. Mendoj se pa ndërhyrjen tonë do të ishin në shtëpi.

kollë dhe aty bashkëpunojmë me mësuesit që të jemi në të njëjtën linjë e të ecim paralelisht me planin që ata ndjekin në shkollë, ose, nëse është një fëmijë që bën fizioterapi, në orën e fizikuturës të bëjë ushtrime që nuk e demotojnë fëmijën. Bashkëpunimi përfshin edhe familjet dhe mbështetjen që prindërit a të afërmit në familje duhet t'i japin fëmijës. Familja ka mbështetje nga punonjësit social. Ato ofrojnë shërbime për prindërit, në mënyrë që të përfshihen dhe të mësojnë diçka nga mënyra e zhvillimit të terapisë. E thënë ndryshe, nëse bëhet terapi për artikullimin, edhe prindi mund të bëjë disa ushtrime gjatë javës me fëmijën. E kemi bërë këtë ndërthurje për të shtruar një rrugë qëndrueshmërie të projektit.

Sa e vështirë është?

Eshtë shumë e vështirë, sepse nënat përveçse janë të ngarkuara me shumë punë shtëpie, nuk e kanë pasur të thjeshtë të mësojnë ushtrimet. Nga ana tjetër, pengesë është dhe mendësia apo besimi që kanë për të ndryshuar jetën e fëmijës. Por kemi raste suksesi, prindër



që janë përfshirë dhe bëjnë shumë punë, në bazë të programit që specialistët iu tregojnë.

Sa e rëndësishme është puna me familjet?

Eshtë një element shumë i rëndësishëm dhe për këtë arsye, World Vision ka mbështetur familjet dhe në rritjen e ekonomisë së tyre, që të kenë një cilësi jetese më të mirë. Katër familjeve u kemi blerë dhi, të tjerave u kemi siguruar orendi shtëpiake, sepse, nëse fëmijët nuk kanë ku flenë dhe hanë gjithçka bëhet edhe më e vështirë. Nga ana tjetër, psikologjia dhe punonjësja sociale bëjnë një punë të drejtpërdrejtë dhe me mënyrën

se si të drejtojnë shtëpinë, punët e shtëpisë, gatimi dhe element të tjerë të domosdoshëm.

Si është bashkëpunimi me strukturat lokale?

Bashkia e Librazhdit, për vitin 2018, ka mbështetur 60 për qind të pagës së shoferit të mjetit që kryen transportin e specialistëve pranë shtëpive të fëmijëve, ndërsa tani jemi në fazën e nënshkrimit të marrëveshjes së dytë. Bashkia ka mbështetur dhe zbatimin e programit. Shërbimi Lëvizës i Programit Tungjatjeta është bërë pjesë e strukturës së saj. Ato kanë një zyrë pranë Shërbimit social. World Vi-



Reportazh/ Mes varfërisë së tejskajshme dhe mundësisë për t'u ringritur

Në Gizavesh të Librazhdit mes fëmijëve që iu rilindën shpresat

Logopedistja e psikologjia: Fillim i vështirë, por do ia dalim së bashku

Një klithmë e butë që zimi dëgjohej pak metra më tej, ndërsa anë gardhit që ndan një grumbull shtëpish me sheshin e fshatit Gizavesh, dy fëmijë, me fytyrën që u shkëlqen nga gëzimi, nisën të rëndnin drejt Eva Buzrës, specialiste logopede të programit "Tungjatjeta" të World Vision e cila së bashkë me psikologjen Mimoza Polisi, sapo kanë mbërritur. Irena 12 vjeçare dhe vëllai i saj më i vogël Maringleni, 10 vjeç, po kthehen nga shkolla. Të dy ata janë me aftësi ndryshe. Irena është diagnostikuar me zhvillim intelektual në kufijtë minimal të normës, ndërsa Maringleni me autizëm femënor. Që të dy janë përfshirë në programin social që ndihmon pikërisht fëmijët me aftësi të kufizuara, të cilët e kanë të pamundur të marrin një shërbim të specializuar.

Eva dhe Mimoza, së bashku me dy koleget e tjera të programit, një fizioterapiste dhe një punonjëse sociale, vizitojnë çdo javë dy fëmijët. Mes tyre është krijuar një lidhje e veçantë, të cilën nuk është e vështirë ta dallosh. Maringleni vrapon i pari dhe ndalon pranë Evës, duke trokitur dorën me të, pastaj rend drejt shtëpisë në pragun e së cilës po pret Mimoza. Edhe Irena është jo aq e gëzuar. Ndërsa duke ju përgjigjur pyetjeve të Evës se si ia kishte kaluar në shkollë, tërhiqet e ndrojtur nga prania jonë.

Vizitat e përjavshme të specialistëve të programit "Tungjatjeta", duket se janë një moment special në jetën e dy fëmijëve, të rrethuar nga një varfëri e skajshme, dhe dy prindër, Dritan e Fatusha, që gjithashtu vuajnë nga probleme të shëndetit mendor. Banesa ku ata jetojnë ka tre dhoma në katin përderishtë të një ndërtese dykatëshe. Derë kryesore janë dy kanatë druri të varur shtrembër në menteshat anësore, të cilat vetëm dyshejmeja e shtruar me cimento duket se i mban ende pa u shkëputur.

Dhoma që do të mund të quhej e ndenjes ka tre divanë të vjetër, një tavolinë të vogël katrore, një lloj bufeje ku në mes qëndron një



Maringleni dhe Irena

televizor, i cili nuk punon, dhe një dritare së cilës i ka mbetur vetëm skeleti. Katorrët ku do duhet të ishin xhamat, janë mbushur me triko, bluza e xhupa të rrënuar për të bllokuar aq sa munden të ftohtit, ndërsa lejojnë vetëm pak, që ngajshhtë të hyjë drita, duke e bërë dhe më të zymtë dhomën ku varet një llambë e zbehtë. Në një kthinë, ndodhet një sobë e madhe e vjetër druri, mbi të cilën qëndron një enë e mbushur plot e përplot me kallinj misri që po ziejnë.

Ndërsa dy specialistet bëhen gati të nisnin punën me Irenën dhe Maringlenin, të dy prindërit qëndrojnë të pranishëm në dhomë. Fatushja nxiton të nxjerrë diçka për të na qerasur. Dritani, ka lënë punët që po bënte në oborr, dhe qëndron në këmbë, ndërsa Eva dhe Mimoza e qortojnë pasi dëgjojnë nga Fatusha se kishte rrahur një prej dy fëmijëve të tjerë, më të vegjël të familjes, të cilët qëndrojnë të heshtur me vështrime kureshtarë për njerëzit që u kanë ardhur në shtëpi. Një prej tyre, vajza 3 vjeçare, vuan, gjithashtu, nga një problem fizik në njërin këmbë, por askush nuk e ka të qartë përse bëhet fjalë. Fatushja, ndërkohë pret dhe fëmijën e pestë.

Eva, specialiste e logopedisë nis ushtrimet me Maringlenin. "Fillimi ka qenë shumë i vështirë", tregon

ajo. "Djali nuk belbëzonte, nuk shqiptonte gërmat. Nuk shfaqte interes për të bashkëpunuar me ne. Shmangej. Nuk preferonte madje as të luante me fëmijët e tjerë dhe qëndronte gjatë gjithë kohës vetëm", shpjegon Eva. Ajo i gëzohet faktit se shumë gjëra kanë ndryshuar te vogëlushi. "Ai tani bashkëpunon me fëmijët, luan me to. Ka filluar të shqiptojë bashkëtingëlloret dhe zanoret e të formojë rrokjet e para apo dhe emrat e parë, Ma, Ba, Gjyshi. Edhe kur kërkon diçka përpjetë që ta shqiptojë fjalën", rrëfen specialistja. Mimoza, psikologja thotë se "me të është kryer një terapi për t'i rritur aftësitë, si të kujdeset për veten, si të ndërtojë marrëdhënie me të tjerët. Dhe në të mësuar kemi nisur nga gjërat më bazike. Të bashkojë pikat, të ngjyrosë brenda kontureve, të njohë pjesët e trupit, të njohë kafshët dhe profesionet. Ato që nuk i shqipton dot, i imiton me gje. Dhe në këtë rast kemi punuar shumë dhe me shkollën që të mos ndjehet i diferencuar".

Situata ka qenë e ndryshme me Irenën, me të cilën psikologjia merret duke i dhënë lojëra formuese: kuba me shkronja të të cilat formon emra, rrathtë që duhet t'i vendosë sipas madhësisë, dhe rruaza shumë të vogla përmes të cilave ajo duhet të kalojë një fill, për të krijuar

varëse apo byzylykë. Fillimisht, 12-vjeçarja kishte qenë shumë e mbyllur në vetvete. Preferonte të komunikonte vetëm me personat që i njohte. Ndërsa kryente veprime që nuk korrespondonte me moshën e saj. Thjesht imitonte të rriturit. "Kur një nga të afërmit e familjes kishte ndërruar jetë, ajo ishte veshur me të zeza, sepse kishte parë që kështu veprohej në të tilla raste", tregon Mimoza, e kënaqur që tanimë vajza, pas afro një viti ka ndryshuar rrënjësisht, siç pohan vetë ajo. "Tani është më sociale, luan me shokët e shoket, bashkëpunon me mësuesit dhe me ne. Kur prindërit i bërtasin, kur diçka nuk i pëlqen, të gjitha gjërat tani i diskuton", na thotë Eva.

Situata ka ndryshuar dhe në shkollë. E mbajnë më afër, e përfshijnë në lojëra që të ndjehet e përkrahur e të fitojë ato çka i mungojnë në familje. Në klasë është me moshatarët e saj. Mësuesit e kanë lënë në bankën e parë që të mos diferencohet. Edhe në aktivitetet ajo përfshihet njëjloj si të tjerët. Irena është përmirësuar dhe në mësim. Një faktor shtesë është dhe fakti që në shkollën "Zeqir Huncin", të fshatit, ka shkuar dhe një mësuese ndihmëse që merret me të dhe vëllain e saj dhe fëmijët e tjerë me problem. "Terapia që kemi përdorur

VIZITAT E FEMIJET

Eva dhe Mimoza, së bashku me dy koleget e tjera të programit, një fizioterapiste dhe një punonjëse sociale, vizitojnë çdo javë dy fëmijët. Mes tyre është krijuar një lidhje e veçantë, të cilën nuk është e vështirë ta dallosh. Maringleni vrapon i pari dhe ndalon pranë Evës, duke trokitur dorën me të, pastaj rend drejt shtëpisë në pragun e së cilës po pret Mimoza. Edhe Irena është po aq e gëzuar.

është një ndërthurje mes këshillimit psikologjik dhe terapisë së zhvillimit. Këshillimi për ta ndihmuar për problemet dhe shqetësimet që ka, ndërsa terapia e zhvillimit për t'i rritur aftësitë që i mungojnë (mënyra se si të komunikojë me të tjerët, si të sillet, si të vishet, të kujdeset për veten), por dhe aftësitë për të mësuar. Shpesh na është dashur të bëjmë dhe një analizë të sjelljes për të zbuluar shkaqet që e kanë çuar në kryerjen e një veprimi të caktuar", shpjegon psikologjia, ndërsa shton se "gjithë këtë siguri që i kemi dhënë e shpreh duke na bërë shpesh kartolina, në shenjë falënderimi".

Edhe këtë herë, Irena, një byzylykë e krijuar prej asaj vetë ia dhuron pikërisht Mimozës, ndërsa varësen e ka për të ëmën. Lidhja e saj me mamën ngjan të jetë tejet e fortë. Për 8 Mars ajo kishte bërë një buqetë me lulet e sapocelura të një peme thane. Më pas në një fletë letre kishte shkruar urimin për festën, mbyllur poshtë me fjalët MAMI TE DUA SHUME!

Nëse nuk do ta dinim problemin e saj, nuk do bënim asnjë dallim nga fëmijët e tjerë, edhe sepse ajo, në bisedat e shkurtër me ne, ndan të njëjtat dëshira, pasione e ëndrra si bashkëmoshatarët e saj. I pëlqen të recitojë, të këndojë, dhe madje nuk mendohet gjatë kur e pyesim se çfarë dëshiron të bëhet kur të rritet: "Doktoreshë që të ndihmoj njerëzit të shërohen".

← sion ofron mbështetje financiare dhe ekspertizën, ndërkohë që Shërbimi Social siguron cilësinë e standardeve. Në prill pritet të nënshkruajmë kontratën e re më bashkinë, e cila do të mbështesë 15 për qind të gjithë projektit.

Cila janë sfidat me të cilat ju haseni në punën tuaj?

Për të arritur zhvillimin e potencialit të fëmijëve, punohet me shkollën, por duke ditur mendësinë, infrastrukturën e shkollave, programet që ato përdorin, për këtë kategori fëmijësh ka shumë vështirësi. Në disa raste na është dashur të punojmë drejtpërsëdrejti me mësuesit e fëmijëve.

Një vështirësi tjetër është rruga nga shtëpia në shkollë. Prindërit detyrohen t'i mbajnë në krahë. Distanca janë të largëta. Infrastruktura që mungon nuk lejon që të transportohen as me karrocet e tyre.

Sfidë më vete është dhe pasja e disa aparatrave që janë shumë të shtrenjta. Ne kemi evidentuar 4 fëmijë që kanë nevojë për pajisje mbështetëse, të cilat janë shumë të shtrenjta, dhe të nevojshme për të terapisë së cilës u nënshtrohen.

ZGJEDHJET NË MAQEDONINË E VERIUT KOMENTET E POLITIKANËVE

VMRO DPMNE

HRISTIJAN MICKOVSKI

"Sot qytetarët duhet të jenë të zëshëm, të dalin masovikisht dhe të vendosin njëherë e përgjithmonë të mposhten padrejtesitë në Republikën e Maqedonisë. Të fitojë drejtësia. Qytetarët duhet të jenë të zëshëm kundër gënjeshtërave, korrupsionit, mungesës së demokracisë në shtet, politikantët e pandershëm përkundër ndershmërisë, sinqeritetit dhe parimit", tha Mickovski.



Kryeminister

ZORAN ZAEV

"Nëse zgjedhjet do të jenë të suksesshme, nëse e ruajmë unitetin në vendin tonë, ecim fuqishëm përpara, drejt botës bashkëkohore së cilës i takon vendi ynë, Republika e Maqedonisë së Veriut. Votimi është nder, e drejtë dhe detyrë qytetare. Sot pres të gjithë qytetarët tanë të zgjedhin presidentin e Republikës së Maqedonisë së Veriut", -tha Zaev.



BDI

ALI AHMETI

"Është me rëndësi që të gjithë t'i pranojnë rezultatet zgjedhore, sepse në procesin zgjedhor ka fitues dhe ata të cilët nuk i kanë realizuar pritjet e tyre. Është shumë me rëndësi që procesi të zhvillohet në atmosferë korrekte dhe demokratike dhe në fund të pranohen rezultatet e këtyre zgjedhjeve nga të gjitha pjesëmarrësit", -tha Ahmeti.



ASH

ZIADIN SELA

"Pres që qytetarët të dalin dhe të votojnë mënyrë të qetë. Të votojnë për shtet juridik, të votojnë për shtet për të gjithë, për vazhdimin e rrugës drejt NATO-s dhe BE-së. Për fat të keq këto ditë ishim dëshmitarë të shantazheve dhe presioneve të bëjës së propagandës së keqe, shumë të ulët nga ana e portaleve që janë të afërta me partinë në pushtet. Mënyrë e vetme që pushteti të distancohet nga këto terme është të funksionojë ligji dhe të dënohen", tha Sela.



KOMENTET

Dje u zhvilluan zgjedhjet presidenciale në Maqedoni. Në garë ishin tre kandidatët për president, Blerim Reka që mbështetet nga opozita shqiptare, Stevo Pendarovski, i partive në pushtet të udhëhequr nga social-demokratët e kryeministrit, Zoran Zaev dhe Gordana Siljanovska e opozitës maqedonase. VMRO-DPMNE. Të tre kandidatët ishin pretendentët për të zëvendësuar kreun aktual të shtetit, Gorge Ivanov. Mësohet se mbi 1.8 milionë votues do të përzgjedhin mes tre kandidatëve. Situata në këto zgjedhje u paraqit e qetë. Sipas rregullit, nëse asnjë kandidat nuk fiton më shumë se 50% të votave dy kandidatët me më shumë vota do të shkojnë në balotazh më 5 maj ku pjesëmarrja e elektoratit duhet të jetë së paku 40% në mënyrë që rezultati të jetë i vlefshëm. Gjatë ditës së shtunë votuan 1.782 qytetarë të regjistruar që jetojnë jashtë shtetit, në 32 përfaqësi konsullore diplomatike. Po ashtu të shtunën votuan edhe 1.640 persona të burgosur, shtatë persona të shpërngulur brenda vendit dhe 3.583 persona të sëmure dhe të moshuar. Marrëveshja e Prespës, reformat, integrimet euroatlantike si dhe shteti qytetar kanë qenë pikat dominuese të fushatës. Ndërkaq Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve ka bërë të ditur se deri në orën 18.30 të drejtën e votës e kanë shfrytëzuar 39.71 për qind e trupit të përgjithshëm votues, apo rreth 600 mijë qytetarë nga afër 1.8 milionë me të drejtë vote. Bazuar në rrjedhën e procesit, sipas KSHZ-së, dalja në votime në këto zgjedhje pritet të arrijë pak mbi 40 për qind. KSHZ-ja ka bërë të ditur se procesi zgjedhor u zhvillua kryesisht në atmosferë të qetë dhe demokratike. Në Maqedoninë e Veriut, në orën 7:00 të mëngjesit janë hapur kutitë e votimit ku rreth 1.8 milionë qytetarë me të drejtë vote do të zgjedhin presidentin e ri të shtetit. Në garë për pasardhësin e Gorge Ivanovit janë tre kandidatët: Stevo Pendarovski, i nominuar nga Lidhja Social Demokratike dhe 31 parti tjera, përfaqësues të Bashkimit Demokratik për Integrim të Ali Ahmetit; Gordana Siljanovska-Davkova, kandidatë e opozitës maqedonase të udhëhequr nga VMRO DPMNE dhe Blerim Reka, kandidat i propozuar nga dy partitë shqiptare të opozitës, Aleanca për Shqiptarët dhe Lëvizja Besa.

Kandidatët do zëvendësojnë Ivanov, bëjnë apel për votime të qeta

Maqedoni e Veriut, 1.8 mln votues zgjedhin presidentin e ri

Agjencia INA: Blerim Reka ka fituar mbi 80 mijë vota



SHKURT

Mihaela Shvicer-Blum, zv/ambasadore e SHBA-së:

Votimi në zgjedhje është pjesë kritike e çdo demokracie dhe është shumë me rëndësi që qytetarët ta ushtrojnë të drejtën e tyre lirshëm dhe pa ndikim. Gjithashtu, rëndësi ka edhe numërimi transparent. I uroj fat gjithsecilit në këtë proces", tha Blum. Zgjedhjet po mbikëqyren nga një numër i madh i vëzhguesve vendor dhe ndërkombëtar. Në KSHZ janë regjistruar 3150 persona ndërsa numrin më të madh prej 1500 vëzhguesve e ka organizata joqeveritare "Most", derisa 400 do të jenë të huaj. Fushata elektorale e kandidatëve për president ka zgjatur 20 ditë. Ajo kryesisht ka qenë e qetë dhe demokratike, por me akuzë të ndryshme mes partive. Kandidatët kryesisht janë përqendruar në çështjet që kanë të bëjnë me Marrëveshjen e Prespës, integrimin evropian, raportet ndëretnike, gjyqësorin, ekonominë si dhe korrupsionin dhe krimin e organizuar. Zgjedhjet presidenciale shihen si test për qeverisjen e kryeministrit Zoran Zaev, pas arritjes së marrëveshjes me Greqinë për ndërrimin e emrit të shtetit në "Maqedonia e Veriut". Ai ka thënë se në rast të disfatës së kandidatit të partive në pushtet, Stevo Pendarovski, do të shpall zgjedhjet të jashtëzakonshme parlamentare. Kjo është kërkuar edhe nga opozita e cila ka kundërshtuar marrëveshjen me Greqinë. Kryetari i VMRO DPMNE-së ka thënë se zgjedhjet presidenciale, në fakt, janë zgjedhje për delegjtimin e qeverisë së kryeministrit Zaev. Ndërkaq mësohet se kandidati i pavarur për president të Republikës së Maqedonisë së Veriut, shqiptari Blerim Reka sipas të dhënave jozyrtare të shtabit analitik të tij ka fituar mbi 80 mijë vota. Kjo është bërë e ditur për INA nga përfaqësues të partive opozitare ASH dhe BESA, që përkrahin kandidatin Blerim Reka. Sipas të dhënave të KSHZ, deri në ora 18.30 në komunat me shumicë shqiptare kanë votuar mbi 160 mijë votues.

KOMENTET

TALAT XHAFERI

"Këto zgjedhje sigurojnë një prej funksioneve në shtet dhe e sigurojnë funksionalitetin e shtetit me çka duhet të sigurohet stabilitet në jetën politike në vend. Dëshiroj që zgjedhjet dhe tërë procesi të vijojë qetë dhe ashtu të përfundojnë deri në fund. Kandidatëve u dëshiroj fat sikur edhe atij që do të fitojë shumicën", -tha Xhaferi.

BLERIM REKA

"Sot është një ditë e madhe, një ditë e shkëlqyeshme jo vetëm me diell, por edhe një faqe e re për historinë e Maqedonisë në raport me Bashkimin Evropian. Shpresoj dhe jam i bindur se këto do të jenë zgjedhje të rregullta, fer, demokratike dhe të lira, që të dëshmojmë se jemi të përgatitur për nisjen e bisedimeve për anëtarësim në Bashkimin Evropian. I ftoj qytetarët që të dalin masovikisht në zgjedhje dhe të shfrytëzojnë të drejtën demokratike për të votuar", tha Reka pas votimit.

STEVO PENDAROVSKI

"Kuptohet, në fund të ditës pres që të kemi përparësi të madhe, e cila do të na jap mundësi që në rrethin e dytë zgjedhor përfundimisht të marrim mbështetjen e plotë të qytetarëve dhe të vazhdojmë rrugën më afër Evropës dhe më larg izolimit", -tha Pendarovski pas votimit.



MJEKU POPULLOR



Ylli Merja:
Kuroni ulcerën
e ngërçet e stomakut
me lulen e basanit

KESHILLA



Si të
parandaloni
obezitetin
te fëmijët

Lorela Garuli:

Psikologia:
Këshilla të
vlefshme për
prindërit e
vogëlushëve
prekur



Shenjat që tregojnë se fëmija juaj ka çrregullime në sjellje

"Kujdes, ADHD shfaqet
para moshës 7-vjeçare

• Mjalti me xhinxher, përzierja e shkëlqyer për imunitetin

Psikologia: Këshilla të vlefshme për prindërit e vogëlushëve të prekur

Lorela Garuli:

Shenjat që tregojnë se fëmija juaj ka çrregullime në sjellje

"Kujdes, ADHD shfaqet para moshës 7-vjeçare

Voltiza Duro

Pra moshës 7 vjeçare, fëmijët mund të shfaqin një lloj çrregullimi të vëmendjes, i njohur ndryshe si ADHD. Në një intervistë për suplementin 'Life Pages' në 'Gazeta Shqiptare', psikologja Lorela Garuli tregon se fëmija mund të paraqesë nivele më të larta impulsiviteti, mungesë vëmendjeje dhe hiperaktiviteti sesa fëmijët normale. Ajo shton se djemtë preken më shumë nga ky çrregullim e më tej tregojnë të gjitha simptomat për 3 kategoritë e grupit të sjelljeve ku fëmija mund të shfaqë çrregullime. Psikologja jep disa këshilla të vlefshme e praktike për të gjithë prindërit e vogëlushëve të prekur nga ADHD.

Çfarë është çrregullimi i vëmendjes?

Çrregullimi i vëmendjes me hiperaktivitet (Attention Deficit Hyperactivity Disorder ADHD) përcaktohet si shfaqja e një grupi sjelljesh ku fëmija paraqet nivele impulsiviteti, mungesë vëmendjeje dhe hiperaktiviteti më të larta sesa fëmijët e tjerë të së njëjtës moshë.

Kur shfaqet zakonisht ky çrregullim dhe kë prek më shumë?

Zakonisht këto vështirësi shfaqen përpara moshës 7-vjeçare. ADHD konsiderohet çrregullimi më i përhapur i periudhës së fëmijërisë së hershme dhe prek më shumë djemtë se vajzat. Problema-

tikat e fëmijëve me ADHD bëhen shkak për shfaqjen e një sërë vështirësive në kontekstin familjar, shkollor, në marrëdhënie me prindërit, motrat/vëllezërit, shokët/shoqet e klasës, me mësuesit e me radhë.

Si kategorizohen simptomat e ADHD?

Simptomat dhe karakteristikat e ADHD ndahen në tri lloje. ADHD ka tre fusha kryesore, të cilat shfaqin problematikat dhe simptomat, përkatësisht: vëmendja, hiperaktiviteti dhe sjelljet impulsive. Mungesa e vëmendjes do të thotë që fëmija bën gabime të shpeshta pakujdesie; nuk i kushton vëmendje detajeve; harron ndjekjen e rutinave dhe detyrave të përditshme;


het lehtësisht.

Cilat janë shenjat e hiperaktivitetit?

Hiperaktiviteti nënkupton që fëmija: Bën lëvizje përsëritëse me duar ose këmbë, në shenjë nervozizmi ose padurimi, nuk rri ulur në klasë apo mjedise të tjera, në të cilat qëndrimi ulur është i nevojshëm, vrapon, kërcën, hidhet së tepërmi në situata të papërshtatshme, flet shumë dhe pandërprerë, është gjatë gjithë kohës në lëvizje dhe duket sikur nuk lodhet kurrë.

Po impulsiviteti si shfaqet?

Kur është impulsiv fëmija ka vështirësi në mbajtjen e radhës dhe kur i duhet të presë, nis të kthejë përgjigje përpara se t'i bëhet pyetja



duket sikur nuk dëgjon kur i flasin; nuk e mban dot vëmendjen në kryerjen e detyrave apo gjatë lojës; ka vështirësi në organizimin e detyrave apo aktiviteteve; nuk i ndjek udhëzimet që i jepen; ka vështirësi në kryerjen e detyrave që kërkojnë ngarkesë të lartë mendore dhe përqendrim (siç janë rëndom detyrat e shkollës); shpesh humb gjëra të cilat janë të domosdoshme për detyrat apo veprimtaritë (libra, fletore); shpërndrohet dhe huto-

e plotë, ndërpret të tjerët kur flasin, futet në mes të një loje, bisede apo aktiviteti që të tjerët po kryejnë.

Sa është i përhapur ky çrregullim dhe cilat janë shkaqet e tij?

Çrregullimi i vëmendjes me hiperaktivitet prek më shumë djemtë sesa vajzat, në një raport 2:1. Në Shqipëri mungojnë shifrat dhe statistikat, por duke iu referuar atyre në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, shpërndarja e këtij çr-



Psikologja Lorela Garuli

ÇFARË DUHET TË BËJNË PRINDËRIT E FËMIJËVE ME ADHD:

- Të nxisin motivimin e fëmijëve, duke treguar njëkohësisht shumë durim me ta.
- Të vendosin rregulla të qarta, të kuptueshme dhe rutina të mirëpërcaktuara.
- Eshtë thelbësore që mjedisi ku jeton dhe mëson fëmija të jetë shumë i organizuar, i pastër, të qetë dhe pa stimuj të panevojshëm.
- Ta ndihmojnë me detyrat e shkollës.
- Të përdorin materiale për të organizuar kohën (ora muri, ora me rërë apo pajisje të ngjashme).
- Të përdorin një ditar ku të shënohen aktivitetet e përditshme të fëmijës.
- Të mbështjellin kopertinat e librave të shkollës, fletoreve, dosjeve dhe materialeve të tjera, me ngjyra dhe formate të ndryshme, për ta ndihmuar fëmijën t'i dallojë më lehtë.
- Të përdorin stenda/tabela/kartona muri në dhomën e fëmijës, ku shënohen oraret e aktiviteteve ditore, javore, mujore të fëmijës.
- Ta angazhojë fëmijën me aktivitete fizike; sportet në skuadra janë një variant shumë i përshtatshëm.
- Të komunikojnë me një gjuhë të thjeshtë, qartë dhe shkurt.
- T'i japin udhëzimet një nga një, me radhë, duke qenë se këta fëmijë kanë vështirësi të mbajnë mend shumë gjëra njëkohësisht.
- Të mos qortojnë në mënyrë të vazhdueshme sjelljet e papërshtatshme të fëmijës; ato që nuk kanë shumë pasoja të rëndësishme, më mirë të neglizhohen.
- Të mos e qortojnë në prani të tjerëve, apo t'u tregojë atyre për "bëmat" e fëmijës (gjë të cilën fatqësisht prindërit e bëjnë shpesh).
- Të përforcohen sjelljet pozitive, përpjekjet e sija për të përparim që bën fëmija, duke theksuar pikat e tij të forta.
- Të kenë një aleancë bashkëpunimi me shkollën dhe mësuesit.

regullimi varion nga 4% deri 7%. Shkaqet e çrregullimit janë gjenetike, pra është një çrregullim që trashëgohet. Gjithashtu, stresi, duhanpirja dhe sëmundje të nënës gjatë shtatzënisë, konsiderohen faktorë të mundshëm. Fëmijët që vuajnë nga ky çrregullim kanë dëmtime në kujtesën e punës, në kontrollin e sjelljeve motorike, në rregullimin e emocioneve dhe procesit të motivimit.

A ka lidhje çrregullimi i vëmendjes me ato të të nxënimit?

Si rrjedhojë e vështirësive në ruajtjen e vëmendjes goftë dhe për të kryer një detyrë të thjeshtë, fëmijët që vuajnë nga ADHD kanë ren-

diment të ulët shkollor dhe vështirësi të shumta gjatë procesit të të nxënimit dhe shkollimit, pavarësisht inteligjencës së tyre që është brenda normave. Kështu, ka një lidhje të ngushtë mes këtyre dy çrregullimeve. Çrregullimi i vëmendjes me hiperaktivitet bashkëshoqërohet me një prej çrregullimeve të të nxënimit (disleksia, diskalkulia, disgrafija) në një masë prej 70%-80%.

Si duhet të sillen prindërit që kanë fëmijë me ADHD?

Prindërit që kanë një fëmijë me çrregullimin e vëmendjes me hiperaktivitet, kanë një rol dhe përgjegjësi direkte sa i përket ndihmës që duhet t'u japin fëmijëve të tyre.

Voltiza Duro

T gjithë ata që vuajnë nga ankthi apo stresi, tashmë mund të përdorin një kurë me bimë medicinale dhe aspak të kushtueshme. Në një intervistë për suplementin "Life Pages" në "Gazeta Shqiptare", mjeku popullor, Ylli Merja tregon se lulja e basanit luan një rol të rëndësishëm në organizmin e njeriut. Sipas tij, kjo bimë ka efekte në të gjithë organizmin dhe ka një përdorim shumë të gjerë. Ndikon në sistemin e tretjes, ka efekte qetësuese në organizëm, prandaj ndihmon në ngërçet e stomakut dhe ndihmon në djegiet e tij gjithashtu. Lulja e basanit ndihmon në shërimin e ulcerës dhe gastritit, prandaj këshillohet të përdoret pothuajse çdo ditë për rreth 45 ditë nga individët që vuajnë nga stomaku.



Mjeku popullor: Efektet kimike të bimës në organizmin e njeriut, si ta përdorni vajin e basanit

Çfarë është lulja e basanit dhe ku mund ta gjejmë atë?

Lulja basani është bimë barishtore shumëvjeçare e familjes Hypericaceae (Guttiferae). Në vendin tonë kjo është një bimë që rritet gjerësisht në zonat e ulëta. Periudha që mblihet lule basani është në fund të majit dhe në fillim të qershorit. Bima mund të përdoret e thatë, ose e njomë. Kur është e njomë, sasia e bimës që përdoret duhet përgjysmuar, pasi përbërësit kimikë janë më të fuqishëm në bimën e njomë. Kësaj bime i përdoren vetëm majat e lulëzuara për veti kurative. Kjo bimë rritet e gjatë deri në 50 cm, por pasi mblihet, pritet rrënja e bimës dhe një pjesë e kërcellit që nuk përmban lule (rreth 20-30 cm të gjata) dhe thahen në hije.

Cilët janë përbërësit kimikë të kësaj bime?

Lule basani përmban shumë përbërës fitokimikë. Ndër këta, në sasi më të mëdha gjenden derivate të fluoroglucinolit në sasinë 0.2-4%, flavonoide (2-4%), taniinë, proantocianidina, acid klorogjenik aminoacide dhe vaj esencial (0.1-0.3%).

Mund të përmendni disa prej vetive kimike të lules së basanit?

Lule basani është një bimë çudibërëse. Ka efekte në të gjithë organizmin dhe ka një përdorim shumë të gjerë. Ndikon në sistemin e tretjes, ka efekte qetësuese në organizëm, prandaj ndihmon në ngërçet e stomakut, ndihmon në djegiet e tij gjithashtu. Kjo bimë ndihmon në shërimin e ulcerës dhe gastritit e prandaj këshillohet të përdoret pothuajse çdo ditë për rreth 45 ditë nga individët që vuajnë nga stomaku. Nëse keni djegie apo kthim të ushqimit, bima ndihmon në rregullimin e funksionit të muskujve të stomakut, duke i qetësuar ato, duke sinkronizuar kështu mbylljen dhe hapjen e këtyre muskujve.

Si ndikon kjo bimë në uljen



Mjeku popullor Ylli Merja

inflamacionit të brendshëm?

Lulja e basanit ndikon në rigjenerimin e mukozave të brendshme të organeve, kështu ul inflamacionin e brendshëm. Nëse konsumoni shumë kafe gjatë ditës, e cila rrit inflamacionin e organeve të brendshme dhe rrit gjendjen e hiperaktivizimit, mund të zëvendësoni një kafe me një gotë çaj me lule basani dhe kështu e ndihmoni trupin tuaj të qetësohet dhe të vazhdojë punën normalisht.

A ka ndonjë efekt lulja e basanit në sistemin nervor?

Bima ndihmon në qetësimin e sistemit nervor. Ndikon në qetë-

simin e ankthit dhe stresit, ndikon direkt në sistemin nervor duke e qetësuar atë, pa shkakuar efekte anësore. Në rast se keni probleme me pagjumësinë apo keni një situatë stresuese, e cila ju ndikon në gjumin tuaj mund të përdorni çdo natë për 30 minuta deri në 1 orë para gjumit një gotë me çaj lule basani. Kjo ndihmon në një gjumë të qetë e në largimin e gjendjeve stresuese. Bima ndikon në rregullimin e sekretimit të hormoneve nga truri, prandaj edhe ka efekte qetësuese. Kështu ndikon në rregullimin e menstruacioneve, sidomos tek femrat që kanë çrregullime hormonale dhe kanë vonesë të ciklit menstrual.

Si mund të përgatitet vaji i basanit?

Lulebasani përdoret e plotë, ose e copëtuar. Mund të përdoret si çaj, ose mund të përdoret vaji i bimës. Doza ditore për të rriturit është 2-4 gram material biomor: Zakonisht, 1 lugë çaji në një gotë me ujë. Rekomandohet 1-2 gota në ditë para ushqimit. Për të përgatitur vaj basani verprojmë kështu: merret lulja e basanit e njomë, priten me gërshtë vetëm lulet e bimës dhe hidhen në një enë qelqi, mbulohen komplet lulet me vaj ulliri dhe lihet përzierja në diell për 45 ditë. Pas 45 ditësh kullohet vaji

dhe ruhet në errësirë. Nga ky vaj konsumohet 1 lugë gjelle në mëngjes çdo ditë përpara ushqimit. Vaji i lule basanit mund të përgatitet edhe me lulen e thatë të bimës, mjafton që përpara se ta futni në vaj lulet e bimës duhet të futen në ujë të valuar përpara për 2-3 minuta. Pastaj lihet të kullojë pak uji dhe futen menjëherë në vaj ulliri.

A gjen përdorim të jashtëm kjo bimë?

Vaji i lules së basanit përdoret edhe për përdorim të jashtëm. Përdoret në trajtimin e plagëve, djegieve dhe pezmatimeve të lëkurës. Vaji i lules së basanit është shumë i fuqishëm në mbylljen e plagëve, ndihmon në rigjenerimin e qelizave të mukozave të brendshme. Përdoret në kremra rigjenerues për plagë si dhe për rigjenerimin e kurimin e hemoroideve në fund të zorrës së trashë. Është ushqyes e rigjenerues i zorrës së trashë. Kremi kundër hemoroideve arrin të hyjë në thellësi të zorrës, pasi përthithet shumë shpejt nga zorra e trashë. Ky krem e ushqen, lubrifikon dhe mbyll plagët e brendshme në zorrë.

Ku duhet të tregohet kujdes gjatë përdorimit të vajt të basanit?

Siç theksova, vaji i lule basanit përdoret për lyerje të lëkurës, por lëkura e lyer nuk duhet të ekspozohet në dritën intensive të diellit. Pasi ndikon në formimin e njollave kafe në trup, nëse ekspozoheni në diell me vajin në lëkurë.

Si të parandaloni obezitetin te fëmijët

Mënyra e të ushqyerit është shumë e rëndësishme për të gjithë individët, por më delikatja fillon që në moshë të vogël.

Studimet e reja tregojnë se ngrënia në fëmijëri mund të jetë një arsye shumë e madhe për të kuptuar se pse shëndeti i tepërt është i vështirë për t'u hequr dhe pse shfaqet obeziteti që në moshat e vogla. Fëmijët, të cilët janë jo aktivë rrinë vetëm para pajisjeve elektronike, nuk bëjnë aktivitet fizik, janë më të rrezikuarit e obezitetit, të cilët cilësohen edhe si viktimat e para të bulizmit. Ku kjo gjë është shumë e vështirë për t'u kapërcyer, sidomos tek moshat e reja ose tek fëmijët.

Tani, në këtë kohë pesha e fëmijës nuk duhet të konsiderohet vetëm si një sjellje ndaj të ngrënit, por ajo përfshin një çështje psikologjike të rëndësishme, ku me anë të saj çdo individ tregon respektin që ka për veten. Pikërisht këtë respekt për veten fëmijët e marrin nga prindërit e tyre që në moshë të vogël. Gjithashtu faktorë të tjerë ndikues janë edhe stresi, por tek fëmijët nuk mund të themi që kjo gjë është e pranishme, sepse stresi i tyre mund të mos jetë aq i madh se sa ai i një të rrituri.

Për këto arsye që fëmijët të mos kalojnë në obezitet që në moshë të vogël, por edhe që prindërit dhe familja të



jetojnë një jetë të shëndetshme, ju parashtrijmë disa këshilla të rëndësishme:

Aktivizohuni në aktivitetet sportive bashkë me familjen tuaj

Mos qëndroni vetëm para televizorit apo në dhomën tuaj, por bashkë me familjen organizoni një lojë ose diçka argëtuese, e cila do të vërë në lëvizje trupin tuaj dhe do t'ju argëtojë për një periudhë kohe. Aktivitetet janë shumë të rëndësishme për një shëndet të mirë dhe për një jetë më të lumtur.

Mos konsumoni shumë ushqim gjatë darkës

Nëse prindërit vazhdojnë me idenë që fëmijët janë të vegjël dhe

gjatë gjithë kohës duan të ushqehen e kanë shumë gabim. Çdo individ ka një normë të caktuar të asaj që duhet të konsumoj. Gjithmonë duhet të keni parasysh që të lini diçka në pjatë para se të mbaroni vaktin tuaj, thonë studiuesit. Sidomos gjatë darkës që ushqimet duhet të jenë më të lehta, orari duhet të jetë



Bëjini vakdet tuaja që të zgjasin disa minuta më shumë

Kjo është pikërisht dhe diferenca që bëhet ndërmjet fëmijëve obezë dhe atyre jo obezë, se sa kohë shpenzojnë ata për të konsumuar një vakt. Shumë mendojnë që qëndrimi më shumë ose më gjatë në tryezë do të thotë konsumim më i madh i ushqimit. Por, studiuesit thonë që nuk është e vërtetë, sepse ngrënia më ngadalë të ngop në mënyrën e duhur dhe eliminon shëndoshjen dhe shfaqjen e dhjamit. Për këtë arsye fëmijët duhet të qëndrojnë më gjatë në tryezë gjatë ngrënies së një vakti.

Provoni të gjitha llojet e ushqimeve të reja

Shumica e fëmijëve sot i shmangen perimeve, sepse preferojnë gatimet e skuqura ose ato që blihen të gatshme. Në këtë mënyrë ata rrisin rrezikun e obezitetit, sepse do të konsumojnë më shumë yndyrë nga ajo që ata kanë nevojë. Prindërit duhet t'i gatujnë edhe përbërësit që fëmijët nuk i preferojnë shumë në një mënyrë të tillë që ata të mos i kuptojnë. Ngrënia e larmishme është mënyra ideale për të shmangur obezitetin dhe për të pasur një shën-

det të mirë që në kohën e fëmijërisë. Të gjithë duhet të jemi të kujdesshëm për sa i përket shëndetit dhe gjërave që ndikojnë në të. Duhet të kemi dijeni në lidhje me gjërat që ndihmojnë dhe atyre që shfaqin rreziqe në shëndetin tonë.

shumë i saktë, sepse studiuesit thonë që ngrënia ideale e vaktit është disa orë para se ju të shkoni për të fjetur. Të gjitha këto duhet të merren parasysh nëse ju dëshironi që fëmija juaj të mos bëhet obez.



Këshilla

Mjalti me xhinxher, përzierja e shkëlqyer për imunitetin

Xhinxheri dhe mjalti mund të konsumohen në formën e tonikut apo shurupit. Kjo arrihet duke krijuar një përzierje të të dy ingredientëve duke i holluar pak me ujë. Ky lëng i vjen në ndihmë aparatit tretës për shkak të vlerave fantastike të xhenxhefilit. Për më tepër, si xhenxhefilu ashtu edhe mjalti kanë vlera antioksidante, dhe si rrjedhojë rrisin fuqinë e sistemit imunitar. Mjafton një lugë me tonik mjaltë dhe xhenxhefil që njerëzit që kanë një sistem tretës të dobët, të ndihen më mirë. Përgatitja është mjaft e thjeshtë. Vloni një enë me 500 ml ujë dhe shtoni xhinxherin e prerë në rriska. Rreth 10 cm gjatësi rrënje xhinxheri është e mjaftueshme. Xhinxheri vlon në ujë për 5-7 minuta dhe më pas hiqet nga zjarri dhe lihet të ftohet pak. Shtohet rreth 200 ml mjaltë dhe pasi të ftohet e gjithë përzierja mund të ruhet në frigorifer dhe të konsumohet çdo ditë. Në ditët kur imuniteti është në rënie një gjysmë gote nga ky shurup do të mjaftojë. Toniku me xhenxhefil dhe mjaltë ka një nivel të lartë proteinash e si rrjedhojë ndihmon sistemin tretës, stimulon shpërbërjen e yndyrave. Nga ana tjetër, toniku stimulon rritjen e florës intestinale që përshpejton tretjen dhe lehtëson lëvizjet e zorrëve. Së fundmi, toniku me mjaltë dhe xhenxhefil ka aftësinë të thithë përbërësit e tjerë nga ushqimi dhe të reduktojë mbetjet. Toniku mund të përdoret edhe nga fëmijët për t'i qetësuar nga dhimbjet e stomakut. Toniku është një zgjidhje që të qetëson se sa një kurë e mirëfilltë medicinale. Për këto arsye, dhe shumë të tjerë shumë njerëz në mbarë botën, mbajnë gjithmonë xhenxhefil dhe mjaltë në shtëpinë e tyre dhe përgatisin këtë pastë sa herë që kanë kollë ose ftohen. Karamelat me xhenxhefil dhe mjaltë janë, gjithashtu, një variant shumë popullore i kësaj përzierje magjike. Nëse keni fytn të acaruar dhe nuk jeni në gjendje



të flisni, atëherë duhet të konsumoni këto karamelat me xhenxhefil dhe mjaltë dhe fyti juaj do të shërohet menjëherë. Përfitimet shëndetësore të mjaltit dhe xhenxhefilit në kurimin e sëmundjeve respiratore nuk kanë të krahasuar. Ndoshta nuk e dinit, por mjalti është një ndërmjetësues i shkëlqyeshëm për të transmetuar vlerat e barishteve dhe erëzave si xhenxhefil apo xhinxheri në organizëm. Si mjalti ashtu edhe xhenxhefilu kanë vlerat e tyre të veçanta, por kombinimi i të dyjave i jep or-

ganizmit një bonus shtesë. Mënyra më e mirë për të konsumuar mjaltë dhe xhenxhefil është të përziesh një lugë me lëngun e xhenxhefilit dhe një lugë mjaltë.

Vlerat e mjaltit me xhenxhefil, shëndeti i zemrës: Toniku i mjaltit dhe xhenxhefilit është plot antioksidantë që zbusin sjelljen agresive të substancave të quajtura prostaglandin. Këto substanca përthithen nga acidet e yndyrës në formën e enzimave. Prostaglandinat gjenden në të gjithë trupin dhe ndihmojnë funksionet e

të gjithë organeve. Sa i përket shëndetit të zemrës, toniku i mjaltit dhe xhenx-



hefilit zbut çrregullimet e enëve të gjakut, ul tensionin e gjakut dhe rrezikun e sëmundjeve si aterosklerozës dhe atakut në zemër.

Astma: Besohet se përzierja e mjaltit me xhenxhefil dhe mjaltë me xhenxhefil dhe mjaltë mund të trajtojë ose të minimizojë efektet e astmës. Ky kombinim është natyrisht çlirues dhe anti inflamator dhe rregullon fluksin e oksigjenit në mushkëri dhe relakson enët e gjakut në mushkëri. Problemet e frymëmarrjes: Përzierja e mjaltit me xhenxhefil është një variant

natyral i një medikamenti që rrit sekrecionet e bronkeve dhe pastron mushkëritë nga mukusi. Kjo do të thotë se mjalti me xhenxhefil ofron çlirim të menjëhershëm për njerëzit që vuajnë nga kolla, i ftohti, fyti i tharë dhe rrufa. I nevojshëm në betejën kundër kancerit: Mjalti me xhenxhefil arrin të reduktojë të vjellat dhe të përzierat që shkaktohen nga kurat e kemioterapisë pas diagnostikimit me sëmundjen e kancerit. Këto procedura janë aq intense sa shkaktojnë shumë të vjella tek pacientët të cilët detyrohen të përdorin zgjedhje alterna-

tive. Xhenxhefilu përshpejton zbrazjen e stomakut sepse ka aftësinë për mirësimin e tretjes. Në këtë mënyrë ndjesia e të vjellës reduktohet. Të përzierat nga kemioterapia shkaktohen si pasojë e cisplatinës, një përbërës i kurës. Xhenxhefilu arrin të balancojë efektet e këtij përbërësi. Xhenxhefilu gjithashtu sugjerohet të përdoret nga gratë shtatzënë sepse redukton të vjellat dhe të përzierat si pasojë e shtatzënisë.



Jorida Tabaku njihet si një ndër femrat më sharmante në politikën shqiptare. Gjithnjë e matur dhe duke ruajtur feminilitetin, Jorida ia ka dalë të jetë një ndër politikanet më të dashura për shqiptarët. Këtë herë një lajm i mirë vjen nga ish-deputetja e Partisë Demokratike. "Gazeta Shqiptare" mëson se Tabaku është shtatzënë për herë të dytë. Duke qenë e angazhuar me aktualitetin politikë, ajo është përpjekur ta mbajë larg vëmendjes mediatike këtë gëzim që po përjeton. Duke qenë se politikanja gëzon linja perfekte, vështirë se mund t'i duket barku i rumbullakosur poshtë veshjeve formale. Kujtojmë se Jorida ashtu edhe si kolegët e saj, është bërë pjesë e protestave, ku edhe pse është hedhur gaz lotsjellës, ajo nuk është larguar.



Jorida Tabaku shtatzënë, ish-deputetja pret fëmijën e tretë




Soni Malaj ka qenë një nga të ftuarat në programin e së dielës "E Diell" në ekranin e "Top Channel". Këngëtarja e njohur ka rrefyer disa nga planet e ardhshme në muzikë, por dhe për mungesën e babait në jetën e saj. Ajo ka pohuar se ka kaluar 20 vite plot me sakrificë dhe pasion për artin dhe se nuk mendonte se do të vazhdonte me këto ritme. E pyetur nga gazetari Ervin Kurti, nëse i mungon i ati, Soni Malaj është përgjigjur e perlotur duke thënë: "Unë kam dashur shumë që ai të më shikonte në një recital, sepse gjithmonë më ka parë në festivale. E vuante shumë atë pjesën emocionale dhe e vuante pjesën e çmimeve, madje më është lutur të konkurroj me këngën "Ndarja" në "Top Fest", sepse më thoshte se emocionohet kur e këndoja". Ky moment delikat nuk ka kaluar pa u ndjerë dhe nga të gjithë të pranishmit në studio, veçanërisht nga moderatoresha Fjoralba Ponari, e cila ka nisur të lotojë. Malaj i është përgjigjur dhe pyetjes se si e ka përballuar ajo ndarjen nga jeta të babait dhe divorcin duke shtuar: "Më besoj që me ndarjen nga jeta të prindit nuk ka krahasim asgjë tjetër, të tjerat janë pjesë të jetës, zgjedhjet nuk shkojnë, por gjëja më e tmerrshme në jetën e një njeriu është kur ndahet nga jeta një familjar. Nuk kalohet lehtë". Ndër të tjera Soni Malaj zbuloi se shumë shpejt në muajin maj do të vijë me një koncert recital, për të cilin është kujdesur deri më tani. Kujtojmë se këngëtarja ka sjellë herë pas here projekte të ndryshme muzikore, duke qëndruar gjithmonë shumë pranë publikut.



Përloket Soni Malaj për humbjen e babait, flet dhe për divorcin

Zbulohet lidhja, ja kush është i dashuri i Era Istrefit

Era Istrefi ka vjedhur vëmendjen e shumë këngëtarëve të njohtë, që pas suksesit në skenat ndërkombëtare. Ajo është shumë aktive në rrjetet sociale, ku nuk mungojnë fotot provokuese, si dhe komentet e ndryshme nga fansat apo miqtë e saj. Ajo çfarë ka rënë më shumë në sy, ka qenë afrimiteti i Erës me DJ e njohur, Diplo. Duke qenë se ky i fundit i komentonte gjatë gjithë kohës në "Instagram", u përfol nga mediat se dyshja mund të ishte në një lidhje. Kjo gjë u hodh poshtë në një farë mënyre, pasi u tha se këngëtarja, në fakt, po përjetonte një romancë me këngëtarin e njohur britanik, Julian Perretta. Së fundmi, Era ka publikuar një foto në "Instagram" ku duket me flokë të verdha të gjata dhe me poza provokuese, ndërsa Julian i ka lënë asaj një koment "romantik": "Forever" (përgjithmonë) ka shkruar ai, duke e shoqëruar me një zemër, ndërsa Era i ka shkruar: "and ever" (dhe përgjithmonë), duke konfirmuar thashethemet për lidhjen e tyre.



Linda Halimi ka zbuluar fytyrën e vajzës së saj, për herë të parë që pas lindjes. Këngëtarja i realizoi një set fotografik, vajzës, e cila ka mbushur dy javë. Kaimana, ka edhe "Instagram" personal, i cili menaxhohet nga prindërit dhe Linda iu ka bërë thirrje që ta vizitoni faqen e saj në mënyrë që t'i shihni të gjitha fotot. Këngëtarja shqiptare jeton prej kohësh në Amerikë bashkë me të burrin e saj.



Sa e ëmbël! Më në fund publikohet fotoja e vajzës së Linda Halimit

FESTIVALI

Margariti:

Ai udhëtoi nga Koreja e Jugut për t'u shpallur fitues në Shqipëri.

Dongho Kim u shpall fitues i edicionit XVII i Festivalit Ndërkombëtar Operistik "Marie Kraja"

Fatmira Nikolli

Kulmoi mbrëmjen e djeshme Edicioni i 17 i Festivalit Ndërkombëtar i Vokalit Operistik "Marie Kraja". Në 20 vjetorin e themelimit të këtij Festivali Ndërkombëtar në natën e parë dhe finalen e madhe nga Kina, Koreja e Jugut, Turqia, Shqipëria, Greqia, Italia, Franca, Rusia, Ukraina, Spanja konkurruan për katër çmime të mëdha. Përballë jurisë ndërkombëtare konkurrentët interpretuan në garën e arive dhe në garën e këngës edhe në natën finale. Ovationet në sallon ishin të mëdha dhe publiku duket se i ka përzgjedhur të preferuarit e tij, por juria ndërkombëtare kryesuar nga Nicolas Payne, drejtor i opera Europa vendosi që çmimin e tretë ta ndajë mes shqiptares Nina Muho dhe turkut Faik Mandu. Çmimi i dytë shkoi për mezzo soprano turke Ezgy Karakaya dhe çmimi i parë për basin nga Korea e Jugut Dongho Kim. Ndërsa juria më e madhe e festivalit, orkestra e TKOB me çmimin best song vlerësoi tenorin rus, Kirill Matiev. Në natën finale të 20 vjetorit të themelimit të festivalit ndërkombëtar "Marie Kraja" të ftuar specialë ishin Tenori me famë botërore Murat Karahan dhe virtuoz i violinës me famë ndërkombëtare, Elvin Hoxha: Të ftuar specialë, tenori me famë botërore, drejtor i rrjetit të operave të Turqisë, Murat Karahan dhe me performancën ekskluzive për herë të parë në Shqipëri të violinistit Elvon Hoxha, fitues i kompeticioneve më të rëndësishme ndërko-



mbëtare. Nata e fundit e Festivalit të 17-të Ndërkombëtar të Këngëtarëve Operistikë "Marie Kraja", një konkurs ndërkombëtar që bashkon artistë nga vende dhe prejardhje të ndryshme kulturore dhe promovon talente të reja në artet operistike, u zhvillua mbrëmjen e djeshme në Tiranë. Që nga viti 1999, Festivali "Marie Kraja" është një shembull i shkëlqyeshëm i suksesit të integritetit nëpërmjet kulturës dhe një platformë e mrekullueshme për të treguar vlerat evropiane. Çmimi i dytë i konkursit u dha në emër të BE-së nga Monika Bylaite, zëvendës Shefja e Delegacionit të BE-së në Shqipëri. Ajo përgëzoi fituesit dhe themeluesen e festivalit Zana Çela, e cila e filloi atë 20 vjet më parë për të promovuar talentet e reja shqiptare dhe e solli atë në njohjen e sotme ndërkombëtare. "Investimi më i mirë që mund të bëjmë, që #Europa mund të bëjë, për vlerat dhe ideat tona të përbashkëta është mbështetja për të rinjtë dhe mbështetja për artin", tha Bylaite.

"Është impresionuese të shohësh se si ky festival është rritur nga një aktivitet me karakter kombëtar, në ndërkombëtar; se si ka rritur numrin e pjesëmarrësve dhe gjeografinë nga Europa në Amerikë, deri në Korenë e Jugut dhe në Kinë, duke e kthyer Tiranën në këto ditë, në një qendër të operistikës."



EDI RAMA

Urime pjesëmarrësve, finalistëve dhe organizatorëve të Festivalit Ndërkombëtar Operistik 'Marie Kraja', për klasin e lartë të këtij aktiviteti tanimë tradicional, që e ka futur Shqipërinë në hartën botërore të ngjarjeve të muzikës operistike.



FITUESIT

- Fitues i çmimit të parë, "Marie Kraja" u shpall bass-i Dongho Kim-Korea e Jugut.
- Fituese e çmimit të dytë, u shpall mezzosoprano Ezgy Karakaya-Turqi.
- Fitues të çmimit të tretë, u shpallën dy konkurrentë (me pike te barabarta) Nina Muho-soprano Shqipëri Faik Mansu-Bariton Turqi.
- Fitues i çmimit "Song prize", çmimi i votuar nga Orkestra e Festivalit, (orkestra e TKOB) u shpall Kirill Matiev-Tenor, Rusi.

Opinioni *i* Ditës

Heqja e vizave, kërkesa e vetme unike e Kosovës në Berlin

Nga Bekim Bislimi

(vijon nga faqja 1)

...Emanuel Macron, për liderët institucional të Kosovës do të jetë rast për të shtruar çështjet me interes për vendin që drejtojnë, përfshirë këtu çështjen e liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës, vlerësojnë njohësit e zhvillimeve politike.

Se çështja e liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës do të shtrohet në takimin e Berlinit, këtë e kanë konfirmuar edhe presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi dhe kryeministri Ramush Haradinaj.

Presidenti Thaçi, në një shkrim në rrjetin social Facebook, ditën e mërkurë, ka theksuar se bazuar në konsultat që ka zhvilluar "nuk do të ketë asnjë plan që do të propozohet për marrëveshjen Kosovë-Serbi" dhe se "nuk ka agjendë të fshehtë prapa këtij takimi".

Por, ai ka shtuar se "për Kosovën do të ishte tepër dëshpëruese në rast se edhe në këtë takim, Franca dhe Gjermania, dëshojnë të harmonizojnë qëndrimet e tyre për vendimin për liberalizimin e vizave" për qytetarët e Kosovës.

Njohësit e zhvillimeve politike, thonë se çështja e liberalizimit të vizave, tashmë është vetëm çështje e vendimit politik të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian. Po ashtu, sipas tyre, edhe ngecja e dialogut Kosovë-Serbi, është kryekëput çështje politike.

Analisti Artan Muhaxhiri, duke folur për Radion 'Evropa e Lirë', vlerëson që pas dritës së gjelbër nga Komisioni Evropian dhe Parlamentit Evropian që Kosovës t'i hiqen vizat, ky proces është komplikuar dhe tashmë është shndërruar në adut politik dhe realizimi i tij varet nga interesat politike të vendeve të BE-së.



"Me vetë faktin që Kosova, zyrtarisht, i ka plotësuar të gjitha kriteret, atëherë kjo gjë tani hyn në domenin e të paparashikuarës, sepse nuk është më një test i cili mund të evidentohet, për sa i përket realizimit apo jo të detyrave dhe obligimeve. Mirëpo, është vetëm akt politik, i cili do të merret në bazë të interesave të faktorëve të rëndësishëm brenda BE-së", theksoi Muhaxhiri.

Taulant Kryeziu, nga Instituti i Kosovës për Politika Evropiane (EPIK), thotë për Radion 'Evropa

e Lirë' që vendimi për liberalizimin e vizave për Kosovën mbetet vendim politik dhe bazohet në disa adresime që kanë të bëjnë me luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit. Por, bazuar në dinamikën e tanishme nuk shihet se ekziston aktualisht ndonjë moment nga vendet e mëdha të Bashkimit Evropian se mund të ketë ndonjë vendim për vizat, përveç nëse ai ndërlihet me dialogun Kosovë-Serbi.

"Kjo është në duart e anëtarëve të Bashkimit Evropian. Pra, kur të krijohet momentum i tyre i

brendshëm dhe kur këto institucionet tona do t'i bindin që janë të gatshme që të luftojnë krimin e organizuar dhe korrupsionin. Tash, a është ose nuk është ky proces i vizave i lidhur me dialogun (Kosovë-Serbi), është çështje e cila edhe mund të jetë, për arsye se është çështje e madhe politike".

"Në qoftë se Gjermania ka interes që procesi i dialogut të fillojë shpejt dhe që taksa (prej 100 për qind, e Qeverisë së Kosovës për mallrat e Serbisë) të tërhiqet, atëherë kundërvlera që mund të ofrojë Gjermania është që të shtyjë

më shpejtë agjendën e vizave", theksoi Kryeziu. Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ditë më parë ka thënë se e konsideron shumë të rëndësishëm takimin e Berlinit, për shkak se sipas tij, Kosova është e interesuar për liberalizimin e vizave dhe ka shfaqur shpresën që të hapet kjo temë.

"Jemi me 29 prill në Berlin. Ajo është një mundësi reale që të ecet përpara me situatën e liberalizimit të vizave. Tash, ne, me idenë e do poenëve të caktuar ose disa situatave të caktuara, qofshin politike, qofshin tjera, duhet të bëjmë një kujdes dhe ta realizojmë qëllimin, që e kemi që 20 vjet, që njerëzit tanë të me qenë njerëz të lirë", ka thënë Haradinaj.

Megjithatë, kryeministri Haradinaj nuk ka dhënë më shumë sqarime se cilët janë ata poenë apo situata të caktuara politike ose të tjera, përmes të cilave synohet të realizohet një vendim i vendeve të BE-së për liberalizimin e vizave për Kosovën.

Analisti Muhaxhiri shpreh mendimin se nga BE-ja mund të pritet çdo lloj oferte në raport me liberalizimin e vizave, por edhe ndryshime të politikës vendimmarrëse në Kosovë.

"Pasiqë liberalizimi i vizave është shndërruar në një kartë politike, atëherë është e mundur që në bazë të interesave edhe të fuqive të mëdha, posaçërisht të Gjermanisë në raport me përfundimin e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, të shfrytëzohet si një nxitje për klasën politike të Kosovës, për Qeverinë e Kosovës që ta largojë taksin, si kundërshpërblim për liberalizimin e vizave", theksoi Muhaxhiri.

Por, Kryeziu vlerëson se mundësia e një oferte të tillë nga BE-ja për Kosovën, ndonëse nuk përjashtohet, tash për tash, ngelet vetëm në suazat e analizave të situatave të mundshme.

"Në qoftë se Gjermania dhe Franca kanë vullnet, atëherë qytetarëve të Kosovës mund t'u mundësohet lëvizja e lirë në zonën Schengen. Në qoftë se shefat e qeverive të këtyre dy vendeve e marrin këtë proces, pra - në kuadër të një analize - në qoftë se këto vende anëtare këtë gjë e kushtëzojnë me rifillimin e dialogut, që nënkupton tërheqjen e taksës dhe pastaj kryeministri i Kosovës e luan, ta quajmë 'këtë lojë' që tërheqja e taksës të përdoret si mundësi që të fitohet procesi i liberalizimit të vizave, është diçka që mbetet të shihet. Kjo për arsye se është në suazat e një analize dhe nuk e dimë saktësisht", theksoi Kryeziu.

Sidoqoftë, presidenti Thaçi, në shkrimin e tij në 'Facebook', ka thënë se Kosova mbetet vendi i vetëm i izoluar në Evropë. Duke shfaqur pritjet e tij për mundësinë që në takimin e Berlinit të harmonizohen qëndrimet e Gjermanisë dhe Francës për liberalizimin e vizave për Kosovën, ai ka theksuar se "të flasësh për perspektivën evropiane të Kosovës, qoftë edhe në mënyrë vetëm retorike, është më tepër se hipokrizi".

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.



Opinion i Ditës

Gjithshka për të rinjtë?

Nga Fatos Çoçoli

(vijon nga faqja 1)

...zgjedhjet e rradhës. Një burrë shteti për brezat që vijnë". Qeveria ngeli në diskutime pa bukë me trupën e trembur dhe të paafit të drejtuesve të sotëm të universiteteve tona shtetërore. Përse e bën një gjë të tillë? Për t'u treguar studentëve se e ka seriozisht Paktin për Universitetin? Kur të vetmen gjë që është në gjendje të bëjë me kuadrin ligjor të sotëm është të përgjysmojë tarifën e shkollimit në universitetet publike (e ka bërë) dhe të investojë më shumë për kampuset- qytetet në miniaturë universitare (po e bën). Por edhe vetë qeveria e di mirë se kaq nuk mjafton. Se nuk është as një e pesta e nevojave për punësim dhe orientim normal të të rinjve tanë. Edhe pse renditeti të dytë në EUropë për nivelin e kalimit në arsimin e lartë (universitetet) të të rinjve tanë (me afro 68 përqind. Na e kalon vetëm Finlanda me 70 përqind!), jemi pas Modalvisë (të fundit) në kontinentin tonë, për nivelin e trajnimit dhe të punësimit ndër të rinjtë. Përqindja jonë e të rinjve të papunë të patrajnuar dhe pa arsim, sipas Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO), është 32.8 përqind (https://www.ilo.org/europe/whatsnew/WCMS_565190/lang-en/index.htm). Praktikisht një i ri i tillë i papunë në tre. Moldavia, vendi më i varfër i Evropës e ka 28 përqind. Është për të pasur turp. Është aktakuza më e fortë për qeveritë tona të pa-përgjegjshme për trajtimin e të rinjve në gati tri dekada. Nuk mjafton vullneti i mirë qeveritar. Nuk mjaftojnë 800 vendet e punës të gjetura në administratën tonë shtetërore për studentët më të mirë (të ekselencës), edhe pse është një risi me vlerë. Me një dallëndyshe nuk vjen pranvera. Qeveria duhet t'i hyjë detit me këmbë. Njëlljo si ka bërë me një veprim dy vjet më parë, bashkëqeverisja me qytetarët. Veprim i cili, edhe pse i ndërmarrë me populizëm të jashtëzakonshëm, sërisht vijon të ushqejë pak shpresë tek njerëzit për drejtesiri në zgjidhjen e hallevet të tyre. Ka një model të mrekullueshëm të punësimit të të rinjve, që është modeli zviceran. Pse të mos e kthejmë ëndrrën tonë të vjetër për të patur në Shqipëri një Zvicër me det? Në Zvicër, kompanitë e vogla dhe të mëdha, fabrikat moderne dhe agjencitë e sigurimit, bankat, spitalet dhe dyqanet e shitjes me pakicë pranojnë nxënës për të kryer praktikën. Në praktike ata përdorin konsumatorët dhe punojnë me makineri të ndërlikuara. Janë 30 përqind e kompanive zvicerane që marrin pjesë në sistemin e arsimit profesional. Pse? Sepse qeveria federale zvicerane (disa kantone jap-



in edhe më tepër) ofron lehtësira të forta fiskale (zbritje tak-sash) për të tilla kompani. Mund ta bëjmë edhe ne? 70 përqind e adoleshentëve në Zvicër e kalojnë javën e tyre duke shkuar sa nga një vend pune në një organizatë sektoriale në një tjetër. Pas dy-tre vitesh trajnimit dhe eksperiencë të tillë të fituar, në këmbim, zviceranët kanë një "kontingjent talentesh", ose si i quajne ndryshe, "profesionistët e rinj". Mund ta provojë qeveria jonë diçka të ngjashme edhe këtu tek ne? Mos po ëndërojmë shumë? Sidoqoftë, presim nga qeveria të bëjë diçka (përtë takimeve-spektakël me pedagogë e drejtues të trembur universitetesh publike dhe me stu-

dentë të përgatitur enkas), për të mos u lënë 40-45 mijë të rinjve 21-25 vjeç të vendit si alternativë vetëm kafenet, në pritje të një mundësie për të emigruar. Jemi ndër vendet e rralla në Evropë (ndoshta Moldavia mund të jetë si ne dhe pak Kosova) dhe në botë, ku brezi i ri (edhe ai që po shkollohet në universitetet tona jobulike) e sheh perspektivën e punësimit në Shqipëri më të errtën e mundshme. Dhe nuk ka hiç besim se gjërat mund të marrin për mirë një ditë tek ne. Një pesimizëm i tillë dhe mungesë perspektive kaq masiv tek brezi më optimist në jetë është katastrofik. Qeveria duhet të fillojë të lëvizë. Ministrat e saj që duhet të mbahen përgjegjës për

çështjet e punësimit, ia vlen të mos kënaqen me rritjen e nivelit të punësimit, ngaqë Shqipërisë i janë larguar 300 mijë të aftë për punë, si emigrantët të rinj ekonomikë në gjashtë vitet e fundit. Po ashtu, të mos kënaqen me një ligj të porsamiratur nga komisionet e Kuvendit për nxitjen e punësimit, pse thjesht përbën një nxirje letrash për disa OJF që duan të justifikojnë disa fonde donatorësh. Nëse duam të japim gjithshka për t'i kthyer shpresën këtij vendi, është tek puna, kujdesi qeveritar për të rinjtë. Kemi 28 vite indiferencë totale dhe vrasare ndaj tyre. Përse të mos e fillojmë me disa trajta të para, goftë dhe të ndrojtura, të modelit zviceran?

HOROSKOPI

DASHI

Ndikimi i planetëve do iu japë më shumë hapësirë dëshirave tuaja gjatë kësaj dite. Po ashtu parashikohen mundësi të reja interesante, si për sa i takon sektorit profesional, edhe atij sentimental.

DEMI

Mund të përballeni me disa tensione sidomos lidhur me sferën familjare dhe romantike. Do të jeni nën ndikimin e favorshëm të yjeve, ku do të rigjeni qetësinë dhe do të keni refleksim të thellë.

BINJAKET

Do të jeni të përfshirë në një gjendje konfuzioni sa i takon sektorit të dashurisë, ku do të ndjeni nevojën për praninë e partnerit. Bëni mirë që të qartësoheni me veten dhe të kuptoni objektivat që keni për të ardhmen.

GAFORJA

Do të jeni nën ndikimin e Diellit dhe Hënës, ku parashikohet një ditë me surpriza. Megjithatë do ju duhet të mbroheni nga disa sulme dhe kritika, të cilat kanë të bëjnë me jetën familjare dhe profesionale.

LUANI

Sot mund të hyni në një periudhë shumë herë më të mirë sa i përket çështjes së dashurisë. Parashikohen zgjidhje të rëndësishme në aspektin profesional dhe përfitime ekonomike.

VIRGJERESHA

Sot mund të përfshihen nga momente kritike sa i takon sferës profesionale. Gjatë kësaj dite do të ndjeni nevojën për të gjetur një zgjidhje dhe ekuilibra të rinj. Megjithatë në dashuri gjërat duken të qëndrueshme.

PESHORJA

Parashikohet një ditë e mbushur me sukseste sa i takon sferës profesionale. Do të jeni nën ndikimin e favorshëm të yjeve, sa i takon sferës sentimentale dhe familjare. Me paratë mund të tregoni pak më shumë kujdes.

AKREPI

Sot mund të lini pas krahëve disa momente stresuese, duke shënuar rikuperim të ndjeshëm në sferën profesionale dhe sentimentale. Megjithatë humori nuk do të jetë në kulmin e tij. Dalja me miqtë do ju ndihmojë.

SHIGJETARI

Duhet të mendojeni që t'i rini fund disa situatave delikate gjatë kësaj dite, të cilat do të jenë shtrirë si në sferën sentimentale edhe në atë profesionale. Bëni mirë që të përshatëni me ndryshime të reja që vijnë në jetën tuaj.

BRICJAPI

Mundohuni që të programoni më mirë jetën tuaj sentimentale gjatë kësaj periudhe. Vërtini vetes objektiva të qarta, lidhur me jetën profesionale dhe do të shikoni sukses konkret.

UJORI

Sot mund të përfshihen nga një periudhë më e mirë ekonomike, e cila ka të bëjë me një investim. Sa i takon fushës së ndjenjave, mundohuni që të kaloni një situatë të këndshme me partnerin.

PESHQIT

Parashikohet një ditë mjaft pozitive, sidomos në sferën profesionale. Do të arrihi etapa shumë të rëndësishme nëse i kushtoni vëmendje detajeve të rëndësishme.

PREMIERLIGA



Liverpooli thyen Kardifin, vijon beteja me Sitin

Liverpuli është kthyer përsëri në kreun e kampionatit anglez, duke shpresuar që të vazhdojë rrugëtimin drejt një titulli kampion që mungon prej shumë vitesh. Skuadra e Jurgen Klop ka mundur dje me rezultatin 2-0 Kardif në fushën e këtij të fundit, me një paraqitje të mirë, por ku

u desh të vuanin shumë derisa gjetën rrjetën. Sfidat u vendos në pjesën e dytë të takimit, kur një goditje nga këndi u dërgua në rrjetë me një gjuajtje spektakolare nga Vijnaldum, i cili kaloi në avantazh të tijtë. Vendasit mund të kishin shënuar golin e barazimit, por shpërdoruan dy raste të mira,

para se Salah të fitonte penalltinë të cilën Milner e ekzekutoi me saktësi për të vulosur suksesin 2-0 që çon Liverpulin në vendin e parë me 2 pikë diferencë nga Siti ndjekës, por me një ndeshje më shumë të luajtur. Ndërkohë, gara për pjesëmarrjen në Ligën e Kampionëve mbetet plotësisht e

hapur pasi edhe Arsenalin i vendi të katërt ka gabuar plotësisht. "Topçinjtë" janë mundur 3-2 nga Kristal Palas në një sfidë ku shumëkush priste që skuadra e Emeri të bënte hapin cilësor dhe të ngjitej në vendin e tretë. Për Arsenalin kjo është humbja e dytë në 3 ndeshjet e fundit në kampionat, që e mban atë në pozicionin e katërt në renditje

Ish-ylli i Kombëtares kuqezi, i ftuar në "Sport News" në "News24", jep mendimin e tij për kampionatin

Shehu: S'është më Tirana e vrullit, Partizani ekip solid dhe serioz

Ish-lojtari i kuq vlerëson në maksimum trajnerin Gega

Ylli Shehu, ish sulmuesi i Partizanit ka qenë i ftuar në emisionin "Sport News", të "News 24", duke analizuar sezonin e ish-skuadrës së tij. Shehu i ka dhënë shumë rëndësi faktit se Partizani nuk ka toleruar edhe pse ka një diferencë të madhe pikësh nga vendi i dytë. "Mendoj që ka qenë një vit i suksesshëm i Partizanit. Afrimi i Gegës dhe i drejtorit ka sjellë ndryshime. Partizani është një skuadër e kompletuar. Janë në rrugën e duhur, ekipi nuk toleron dhe po bën mirë deri tani".

Sfida me Kastriotin?

"Duke qenë një diferencë e madhe mund të toleronte Partizani. Megjithatë Partizani tregoi që ka një seriozitet këtë vit. Janë një grup që duan të luajnë mirë. Kështu ata i kanë dhënë një asist Tiranës. Edhe pse në kemi një armiqësi me Tiranën, e duam në vendin e parë. Ne e duam një derbi të kryeqytetit, se ka atmosferë të jashtëzakonshme."

Gega?

"Ai ka meritën më të madhe. Që kur mori grupin në zotërim dhe me afrimet që bëri, formoi një grup që në 30 javët e kampionatit i ka hapur shumë probleme çdo ekipi. Çdo ekip ka hasur vështirësi nga loja e grupit që ka bërë Partizani. Për mua merita kryesore është e Gegës, ai i ka stërvitur nga të gjitha këndvështrimet, psikologjikisht dhe fizikisht. Gjatë gjithë lojës lojtarët mbajnë një temp konstant. Janë kompakt gjatë gjithë 90-minutëshit."

Çfarë ka ndryshuar te Partizani i këtij sezoni?

"Ka tre vjet që Partizani ka qenë në ujërat e titullit. Ka rivalizuar shumë. Këtë vit dhe ana psikologjike dhe ftohtësia e klubit kanë ndikuar. Janë mundur ta mbajnë euforinë dhe të shohin ndeshjet radhë pas radhe. Trajneri ka ditur të marrë maksimumin e tyre."

Kartoni i Rexhepit?

"Për mendimin tim ishte i drejtë. Ishte i drejtë arbitrimi. Është dhe terreni që krijonte shumë faulle".

Merkatot?

"Gjëja më kryesore që ndodhi te Partizani ishte se ruajtjen grupin duke mos bërë ndonjë prurje tjetër në janar. Grupi ishte shumë mirë dhe funksiononte shumë mirë. Ka qëlluar që



janë shkëputur shumë pikë larg. Pjesa e harmonisë te grupit ka të thotë shumë. Varet se si mund ta presin lojtarin e ri. Për mua Partizani bëri mirë që nuk ndërhyri shumë në merkato. Ka mundësi të bëjë dhe tre gabime deri në fund. Besoj që me këtë seriozitet që punojnë nuk do

gabojnë dhe do sjellin titullin".

Tirana?

"Ka një ekip të mirë, ka një grup që luajnë mirë. Bëjnë disa gabime foshnjara, që kanë sjellë disa humbje. Nuk mund të thotë trajneri bëhet kështu ose ashtu, nuk duhet t'i thotë trajneri. Nuk është

më ajo Tirana e vrullit, tani e mban më shumë topin. Me lojërat që ka zhvilluar ka treguar që është një ekip që fiton dhe jashtë dhe brenda. Ka një ndeshje me Kastriotin, ajo do të jetë më decizivja".

Siguria në stadume?

"Ky kampionat do t'i ketë stadiumet bosh, e kam thënë më përpara. Dënimet duhen bërë. Pjesa individuale duhet zgjidhur. Kurse ata dënojnë kolektivin, ekipin dhe pjesën tjetër; që do të shkojë në stadium për të parë ndeshjen. Ata 10, 20, 30 veta që godasin dhe ushtrojnë dhunë duhet të dënohet. Pasha bosh është e vdekur, s'ka emocion".

Kampionati?

"Çdo ndeshje tani është shumë e bukur për t'u parë se ka shumë seriozitet. Luhet në çdo front edhe Skënderbeu kërkon të futet në zonën e Europës, duke luajtur shanset e veta."

Trajneri i Junajtidit

Solsjaker kërcënon lojtarët: Unë do mbahem mend, jo lojtarët



për vete. Ne duhet të kërkojmë falje ndaj tifozëve pasi ata ishin fantastikë. Kjo paraqitje nuk është e mjaftueshme për një ekip të Manchester Junajtidit, duke filluar nga unë për të vazhduar

te lojtarët. Ne zhgënjyem tifozët, klubin. Është një paraqitje shumë e vështirë për t'u përshkruar pasi ishte aq e keqe. Unë dua që skuadra ime të jetë ekipi që punon më shumë në këtë kampionat. Kjo është ajo që ishim nën drejtimin e Sër Aleks. Çfarëdo loj talenti që kishë, duhet të vrapoje më shumë se të tjerët. Duhet ta bëjë për skuadrën. Unë do të bëhem i suksesshëm këtu, por ka futbolistë të cilët nuk do të jenë pjesë e atij ekipi të suksesshëm", ishte kërcënim i hapur i tij drejtuar lojtarëve.

GREQI

Fund pritjes 34 vjeçare, PAOK-u kampion


PAOK i Selanikut i ka dhënë dje fund makthit 34-vjeçar, duke fituar titullin e tretë kampion në historinë e tij. Klubi I Selanikut, ka siguruar vendin e parë matematikisht vetëm një javë para fundit të sezonit, me fitoren 5-0 ndaj Levadiakos, duke lënë 5 pikë mbraja ekipin e Olimpiakosin e mbyllur diskutimet. Siç pritej, pas ndeshjes ka shpërthyer festa në stadium, por edhe në rrugët e qytetit, ku me mijëra tifozë kanë festuar këtë titull që pritej prej shumë kohësh. Tifozët kanë ndezur fishekzjarrë duke festuar këtë ditë të shënuar për ta, për një titull që udhëton shumë rrallë drejt Selanikut. Sa u përket skuadrave të futbollistëve të kombëtares shqiptare, Arisi mbetet në vendin e pestë, ndërsa Panathinaikos në të 7-in. Ndërkohë, PAS Janina e Andi Lilës për momentin është në zonë e ftohtë dhe nëse nuk fiton në javën e fundit, rrezikon seriozisht të bjerë nga kategoria.

INTERI

Vjen Zhang, dridhet stoli i Spaletit

E ardhmja e Interit vendoset në javën e ardhshme. Jo vetëm sa i përket renditjes në kampionat pas duellit delikat me Juventusin, por edhe sa i përket merkatos për edicionin e ardhshëm e sidomos situatës së trajnerit. Në Milano ka zbarkuar vetë Steven Zhang, i cili do të vendosë pikat mbi "i" sa u përket temave më të nxehta. Presidenti i zikaltërve gjendet prej dy ditësh në Milano, ndërsa gjatë kësaj jave në zyrat e klubit do të zhvillohet një mbledhje mes të gjitha palëve të përfshira për të caktuar fillimisht buxhetin për merkaton e verës. Marota, Auxilio dhe Gardini duhet të paraqesin bilancet dhe pritisshmëritë, para se drejtuesit kinezë të fusin dorën në portofol për të bërë investimet e radhës. Megjithatë, gjithçka fillon te projekti për trajnerin e ri. Në klub nuk kanë vendosur ende se çfarë do të ndodhë me Spaletin, por gjithçka do të sqarohet pas kësaj mbledhje, ku pritet që Marota të propozojë emrin e të preferuesit të tij, Antonio Kontes.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

- Janë luftarake me kung fu.
- Është me helm ajo e agjentëve.
- Skuadra merengue.
- Fillojnë tatëpjetën.
- Ed aktor.
- Një pjesë... orkestrale.
- Një iranian i dikurshëm.
- Janë tek në kanape.
- I bën kush ha bukë.
- Fundi i një fundi.
- Fillojnë aksionin.
- Janë zeshkanë.
- Shumë zëra në këngë.
- Gjysmë tuneu.
- Është grykësi
- Rastisin në krye.
- Sikur ke thënë çdonjerin.
- Janë vite.

- Angot e Lecoq.
- Ende është ndryshe.
- Kush bën... ve në lojë.
- Janë grimca me bërthama.
- Turner këngëtare.
- Të parat në bllok.
- Diftong për leader.
- Dhe Hajria në një balet.
- Neill aktor.
- Ross këngëtare.
- Mund të jetë parabolike.

VERTIKAL

- Janë kundërmuese.
- Vveri pa kufij.
- Kush nuk ka... nuk di të sillet.
- Artikull spanjoll.
- Është krimb për grep.
- Mbyllin një krah.
- Edouard piktor.
- Fillojnë profesionin.
- Turke pa kufij.
- Ishte Gjermania e Honecker
- Janë më shumë se dëshira.
- Janë ujërat në lixha.

- Bëhet me kandar.
- I dëgjoi vetëm Odiseu.
- Fillojnë hetimin.
- Një qendër.
- Është vjedhje.
- Makashi këngëtar.
- Me Alfa në makinë.
- Loriku te Sunderland.
- Një pjesë e momenteve.
- Gjysmë tatimi.
- Janë legjenda.
- Nget edhe ajo e mirë.
- Myslymi i pasharruar i futbollit.
- Ki Moon i OKB.
- Flemig që krijoi James Bond.
- Fillojnë hapur.
- Mbyllin komentin.
- Fillojnë sefte.
- Fillojnë masat.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


- Është kombëtare me minoritetin.
- Janë godinat e banimit.
- Van Nistelrooy bomber.
- Është e e pas Krishtit.
- Një fjalë para kohe.
- Organizma Tregare Lokale.
- Rripi pa zë.
- Filoko aktor
- Volumi i shkurtër.
- Është diletant.
- Kufizojnë pozicionin.
- Është X ajo e sulmit.
- Ishin shoqëruesit e Panit.
- Kufizojnë katete.
- Janë çupa.
- Bartok kompozitor.
- Tri të parat në atletikë.
- Tekat pa kufij.
- Një pemë.

VERTIKAL


- Janë shkaktarë shëri.
- Kanë bërë vepra.
- Është shtëpi me frëngji.
- Filimi i ideologjisë.
- Inicialet e Einstein.
- Janë gazetat si RD.
- Loth në kufij.
- Është lumi i harresës.
- Është për medaljen e parë.
- Një fjalë që tregon ritmin.
- Kolegji i famshëm anglez.
- Janë pesë të tillë olimpikë.
- Janë zengjinë.
- Kishte 100 porta.
- Një pjesë e masakrës.
- Mbarojnë fare.
- Janë toka edhe sportive.
- Stoker që shkroi Dracula.
- Është byrek.
- Hapur pa kufij.
- Pal latinisht.
- Rraçe pa re
- Film i famshëm me Brad Pitt dhe Kevin Spacey.
- Oyetti i përjetshëm.
- Një jepet për hartim.
- Jessica aktore.
- Cruise aktor
- Janë në kupë.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

	4		9	7		2		1
	3							
		5						
1		4						
3			8					5
			5		7			
				6				8
5		8	3			6	7	
	1						4	

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

3	2	5	1	6	8	4	7	9
4	6	9	5	7	2	8	1	3
1	7	8	9	3	4	6	5	2
2	9	6	8	4	7	1	3	5
5	8	3	6	9	1	2	4	7
7	1	4	2	5	3	9	6	8
6	4	7	3	8	9	5	2	1
9	3	2	4	1	5	7	8	6
8	5	1	7	2	6	3	9	4

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Argëtim filozofik

- Statistikat thonë se një në katër njerëz vuajnë nga një çrregullim mendor. Mendoni për tre miqtë tuaj më të mirë. Nëse ata janë të shëndetshëm, atëherë ju keni një problem.
 - Nuk e ka fajin pasqyra ... në qoftë se hunda juaj është e shtrembër.
 - Dru jeni të sigurt që keni të drejtë, nuk ka nevojë për të diskutuar me ata që janë gabim.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

E	L	E	K	T	R	I	K	K	U	R	A	D	R	I	T	A	R	E	T	B	O	T	E
T	E	R	R	E	N	I	K	A	N	A	L	O	R	A	P	F	B	E	L	A	T		
I	R	M	A			F	O	N	I	K	E	B	I	K	O	L	O	N	E	L	B	I	
K	A	V	I	K	T	I	M	A	T	K	I	F	I	T	O	R	E	T	T	E	K		
A	M	A	R	R	E	Z	I	T	E	S	K	O	M	E	N	T	E	T	E	L	E		
M	E	T	E	O	R	I	T	E	T	A	H	A	R	E	M	E	R	E	R	A	T		
R	O	M	A	N	T	I	K	E	T	Z	N	T	A	M	T	A	M	A	S	R	A		
E	N	E	D	A	T	I	K	O	N	D	S	A	E	D	S	T	I						
C	I	C	E	L	A	I	K	O	N	D	T	E	K	S	T	M	I	T	E	T			
E	T	E	R	O	L	A	Z	A	R	E	H	R	R	I	K	I	L	O	N	I			
T	O	E	A	F	A	T	A	L	M	I	R	I	A	M	K	R	E	R	E	T			
A	R	K	I	V	A	T	D	A	K	E	T	I	T	A	P	I	N	A	T	I	O		

Thënie të mençura

- Njeriu inteligjent do të gjej rrugëdalje
- nga një situatë e vështirë. I mençuri nuk do të gjenden në këtë situatë.
- Mos ki nevojë për asgjë, dhe do të kesh gjithçka.
- Mos ki nevojë për asnjë, dhe do ti kesh të gjithë.
- Nuk ka rëndësi se kush je dhe sa i bukur je, përderisa ekziston dikush që të dashuron.

PËRGIJËT E FJALËKRYQJVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)



